



# USAID

NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



DEMOCRACYPLUS

# ROLI I ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT NË MOSEFIKASITET NË PROKURIM PUBLIK

Periudha e monitorimit  
1 qershor 2018 – 31 maj 2019





# ROLI I ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT NË MOSEFIKASITET NË PROKURIM PUBLIK

Periudha e monitorimit  
1 qershor 2018 – 31 maj 2019

**AUTOR:** Agon Hysaj  
**EDITUAR NGA:** Roberta Osmani

Qershor 2019

Ky raport është përgatitur nga Demokracia Plus (D+) dhe mbështetur nga USAID përmes aktivitetit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM). Qëndrimet e autorit të shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



# PËRMBAJTJA

<b>LISTA E SHKURTESAVE.....</b>	<b>6</b>
<b>PËRMBLEDHJE .....</b>	<b>7</b>
<b>HYRJE.....</b>	<b>8</b>
<b>OSHP NË PERIUdhËN QERSHOR 2018 – MAJ 2019.....</b>	<b>9</b>
Dallimet në mes të rekomandimeve të ekspertëve dhe vendimeve të panelit.....	11
Vonesat në vendimmarrje .....	12
Transparenca.....	13
Rivlerësim, rivlerësim, rivlerësim .....	13
Pretendimet e pabazuara, ankesat aprovohen .....	14
<b>VENDIMET JOKONSISTENTE.....</b>	<b>15</b>
Vendimet për pagë neto/bruto .....	15
Vendimet për tejkallim të buxhetit të planifikuar.....	17
Tejkallim buxheti – trajtim i pabarabartë .....	20
Vendimet për ankesat në kritere të dosjes së tenderit.....	21
Vendimet për tenderët jonormalisht i ulët .....	22
Vendimet për vërtetimin se kompanitë nuk kanë borxhe ndaj ATK-së .....	23
Vendimet për nënvizim të katalogut .....	26
Vendimet për numra pas presjes dhjetore.....	26
Vendimet për deklaratën mbi specifikat teknike.....	27
Vendimet jonkonsistente për tender të njëjtë .....	29
<b>VENDIMET PËR LISTËN E ZEZË.....</b>	<b>32</b>
<b>VENDIMET PËR (MOS) GJOBITJE TË AK.....</b>	<b>35</b>
Gjoha kundër Trepçës.....	35
Mos gjoha ndaj Ministrisë së Infrastrukturës .....	36
<b>REKOMANDIMET E EKSPERTËVE .....</b>	<b>37</b>
Rekomandimet jokonsistente të ekspertëve .....	38
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>40</b>

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>AK</b>	Autoriteti Kontraktues
<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës
<b>BQK</b>	Banka Qendrore e Kosovës
<b>DT</b>	Dosja e Tenderit
<b>FDT</b>	Fleta e të Dhënave të Tenderit
<b>FPP</b>	Fjalori i Përgjithshëm i Prokurimit
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>KRPP</b>	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
<b>LPP</b>	Ligji për Prokurim Publik
<b>MI</b>	Ministria e Infrastrukturës
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>OE</b>	Operatori Ekonomik
<b>OEA</b>	Operatori Ekonomik Ankues
<b>OSHP</b>	Organi Shqyrtues i Prokurimit
<b>TEAM</b>	Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse
<b>ZKA</b>	Zyrtari Kryesor Administrativ
<b>Udhëzuesi</b>	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik
<b>USAID</b>	Programi i Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara

# PËRMBLEDHJE

Ky raport shqyrton vendimet dhe praktikat e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) për të vlerësuar se sa efektive kanë qenë masat të cilat janë ndërmarrë dhe sa ka qenë e paanshme OSHP-ja në ndarjen e drejtësisë për palët.

Sikurse në raportin paraprak, edhe tek ky raport gjetjet tregojnë për mungesë të konsistencës ndërmjet një numri të vendimeve të OSHP-së, të cilat bien në kundërshtim me vendimet paraprake. OSHP nuk duket se ka praktikuar ndonjë metodologji të krahasimit të vendimeve paraprake, në rastin e trajtimit të ankesave. Nëse kjo do të praktikohet, me gjasë edhe numri i vendimeve jokonsistente do zvogëlohet. Në vazhdimësi, D+ ka theksuar nevojën për standardizim më të madh të vendimeve të OSHP-së, në atë mënyrë që një vendim të jetë arsyeshëm dhe i parashikueshëm nga palët, për shkak të ekzistimit të precedentit.

Numri i ankesave në vitin 2018 ka shënuar rritje të madhe, me 210 ankesa më shumë të dorëzuara sesa në vitin 2017. Trendi i njëjtë i ankesave pritet të jetë edhe në vitin 2019. Kjo përbën një rritje prej 38% në volumin e punës së OSHP-së, e cila funksionon me kapacitete minimale, pasi që vetëm tre nga pesë anëtarë sa duhet t'i ketë OSHP sipas ligjit, janë duke ushtruar funksionin aktualisht, pasi të tjerëve u ka përfunduar afati. Kjo shkakton edhe vonesa në vendimmarrje, ku koha mesatare për marrje të një vendimi në periudhën 1 qershor 2018 – 31 maj 2019 ka qenë 40 ditë, ndërsa afati ligjor është 34 ditë.

Çështje tjetër e trajtuar në këtë raport e që në OSHP shfaqet si dilemë e shpeshtë, është shqyrtimi i rasteve ku pretendimet ankimore nuk kanë të bëjnë me shkeljen e Ligjit të Prokurimit Publik, por ligjeve të tjera të veçanta apo akteve nënligjore. Për shembull, në shumë vendime OSHP ka përdorur arsyetim se në dosje të tenderit (DT) nuk është kërkuar që të respektohet Ligji i Punës prandaj mosrespektimi i tij nuk përbën shkelje për OSHP-në nëse nuk është kërkuar shprehimisht në DT.

Ndërsa në një rast kishte thënë që operatori ekonomik (OE) ankues nuk kishte ofertuar sipas tarifave për sigurim të automjeteve siç përcaktohet nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), edhe pse tarifat nuk ishin kërkuar në dosje të tenderit. Ky rast është vetëm një shembull se si vendimet e OSHP-së për çështje në esencë të njëjta, vendosen ndryshe nga paneli. Për më tepër, ka raste kur paneli nuk merr vendim përfundimtar për një çështje, por të njëjtën e zvarrit duke e kthyer rastin në rivlerësim dhe duke e bartur përsëri përgjegjësinë tek autoriteti kontraktues.

Çështje tjetër e trajtuar janë rekomandimet e gabuara që në disa raste kanë dhënë ekspertët. Paneli duke mos pasur njohuri të duhura në fusha të caktuara, në disa raste vendimin e merr duke u bazuar tërësisht në rekomandimet e ekspertëve, të cilët në raste të caktuara kanë dhënë rekomandime të gabuara që nga llogaritje të thjeshta matematikore e deri në deklarimin se një dokument nuk është kërkuar në dosje të tenderit, i cili në fakt ishte kërkuar.

Raporti gjithashtu ofron rekomandime rreth shmangies së vendimeve jokonsistente, vendimeve për listën e zezë, monitorimit dhe kontrollimit të rekomandimeve të ekspertëve, rritjes së transparencës si dhe nevojës për bashkëpunim më të mirë me prokurorinë.

# HYRJE

Një kompani e cila pretendon se është shpallur e papërgjegjshme në një aktivitet të prokurimit nga një autoritet publik, në kundërshtim me rregullat dhe praktikën e prokurimit publik, duhet të ketë një mënyrë të ankimit-it. Të tillë në Kosovë kompanitë e kanë OSHP-në që është e mandatuar t'i mbrojë ato nga vendimet e paligjshme të autoriteteve kontraktuese.

D+ monitoron seancat e hapura të OSHP-së që nga dhjetori i vitit 2016. Qëllimi i këtij monitorimi është sigurimi i konsistencës dhe paanshmërisë në vendimmarrje. Përmes raporteve të kaluara dhe këtij aktual, D+ synon që të përmirësojë cilësinë e vendimmarrjes së OSHP-së, në mënyrë që vendimet të merren sa më shpejtë që është e mundur dhe të jenë sa më të drejta për palët. Po ashtu, D+ angazhohet që OSHP t'i arsyetojë më mirë vendimet e saj, në mënyrë që një vendim të mos i shërbej thjeshtë një pale në proces, por të përbëjë edhe një precedent për rastet e ardhshme.

Në katër raporte të monitorimit, D+ ka gjetur se problemi më i madh është jokonsistenca në vendimmarrje. Mungesa e një databazë të brendshme ka bërë që OSHP të ketë shumë probleme me konsistencë të vendimeve. Përveç kësaj, sistemi aktual ku një kompani ankohet, OSHP kthen tenderin në rivlerësim, e përsëri ka ankesa nuk arrin qëllimin e ligjit për prokurim efikas. Gjatë vitit 2019 ka filluar procesi i shkrimit të një ligji të ri për të adresuar disa nga problemet me ligjin aktual. D+ është pjesë e grupit punues, duke avokuar, ndër të tjera që OSHP të vendosë se kush duhet të jetë fitues i tenderit, duke përcaktuar kompanitë e përgjegjshme dhe të papërgjegjshme.

Ky sistem ndikon në jetën e përditshme të qytetarëve duke shkaktuar vështirësi në jetën e tyre. Sistemi aktual ka qenë shkaktar që disa fshatra në komunën e Dragashit të presin për ujësjellës për tri vite me rradhë, disa fshatra të komunës së Ferizajt të mos kenë rrugën e asfaltuar që tri vite dhe komuna e Gjakovës të mos mund të blejë një pajisje GPS që një vit, ndër shumë raste të tjera.

Problem tjetër mbetet lista e zezë joefektive. Me sistemin aktual, një kompani mund të diskualifikohet nga prokurimi për një periudhë të caktuar, të dënohen pronarët e saj dhe e njëjta mund të marrë pjesë prapë në tender. Mungon një sistem i teknologjisë së informacionit ku këtyre kompanive do të ju bllokohej qasja në sistem të e-prokurimit. Interpretimi që OSHP i bën ligjit aktual është se një kompani nuk diskualifikohet nëse ajo shkel kushtet e kontratës ose tërhiqet pasi zgjedhet fituese. Në një rast OSHP ka aprovuar ankesën e një kompanie, edhe pse ajo ishte konstatuar se pronarin e ka të dënuar për mashtrim dhe falsifikim, në një vendim të mëhershëm të OSHP-së<sup>1</sup>.

1 Në vendimin 232/16 OSHP kishte vërtetuar se Conex Group e kishte pronarin të dënuar për falsifikim, mashtrim dhe deklarim të rremë nën betim. Megjithatë OSHP aprovoi ankesën në vendimin 355/17 për autostradën Prishtinë - Gjiilan.



# OSHP NË PERIUDHËN QERSHOR 2018 – MAJ 2019

Demokrati Plus (D+) në periudhën 1 qershor 2018 deri më 31 maj 2019 ka bërë monitorimin e seancave të hapura të OSHP-së. Brenda kësaj periudhe janë marrë 779 vendime. Nga monitorimi i seancave, vendimeve të panelit, ekspertizave dhe ankesave, D+ ka gjetur se OSHP për këtë periudhë ka marrë këto lloj vendimesh:

Nga 779 vendime, në favor të operatorëve ekonomik ankues (OEA) janë 429 sosh<sup>2</sup>, në 29 raste janë tërhequr ankesat, në 42 raste paneli ka nxjerrë njoftim<sup>3</sup> dhe 279 vendime janë kundër OEA-ve<sup>4</sup>. Në 27 vendime që janë pro OEA-ve, OSHP ka dhënë edhe urdhëresë për mosrespektim të vendimeve paraprake nga autoritetet kontraktuese (AK).<sup>5</sup>

Vendimi	Vendimi i panelit të OSHP-së	Rekomandimi i ekspertit
Aprovim i ankesës	134	182
Aprovim i pjesërishëm i ankesës	295	248
Tërheqje e ankesës	29	-
Njoftim	42	-
Çështje e gjykuar	-	11
Refuzim i ankesës	45	203
Ankesa e palejuar, vërtetohet vendimi i AK	18	11
Ankesa jashtë afatit ligjor	10	4
Aprovim i pjesërishëm i ankesës, vërtetohet vendimi i AK	206	96
<b>GJITHSEJ</b>	<b>779</b>	<b>755</b>

**TABELA 1: Numri dhe lloji i vendimeve të OSHP-së për periudhën 1 qershor 2018 – 31 maj 2019**

2 Çështje e gjykuar apo Res Judicata është kur OSHP ka marrë një vendim më herët për pretendimet ankimore të ankuesit. Nëse kompania e njëjtë përsëri ankohet me të njëjtat pretendime, atëherë eksperti sipas Rregullores së Punës së OSHP e cilëson ankesën si çështje të gjykuar.

3 Vendimi pro OEA cilësohet aprovimi dhe aprovimi i pjesërishëm i ankesës.

4 Paneli nxjerr njoftim kur operatori ekonomik ankues dhe autoriteti kontraktues pajtohen me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

5 Vendim kundër OEA cilësohet kur refuzohet ankesa, cilësohet si palejuar, e pasafatshme dhe kur aprovohet pjesërisht ankesa, por vërtetohet vendimi për dhënie të kontratës.

Për vendimet e përmendura në Tabelën 1, për 707 vendime është mbajtur seancë, 643 prej tyre (91%) kanë qenë seanca të hapura, ndërsa 64 (9%) të mbyllura.

Ankesat e OE janë kryesisht rreth njoftimit për kontratë, njoftimit për dhënie të kontratës dhe njoftimit për anulim të tenderit, me numrin më të madh të ankesave kundër njoftimit për dhënie të kontratës. Megjithatë ka shumë raste kur OE

ankohen kundër njoftimit për dhënie por në ankesë ka shumë pika që kanë të bëjnë me kriteret e tenderit për të cilat OE duhet të ankohen kundër njoftimit për kontratë.

Lloji i ankesës	Numri
Ankesë kundër njoftimit për kontratë	39
Ankesë kundër njoftimit për dhënie të kontratës	581
Ankesë kundër njoftimit për anulim të tenderit	152
Ankesë kundër njoftimit për kualifikim	1
Ankesë kundër njoftimit për poentim	1
Ankesë kundër njoftimit për eliminim	2
Ankesë për moszbatim të vendimeve të OSHP-së	3

**TABELA 2:** Ndarja e ankesave sipas llojit të ankesës për periudhën qershor 2018-maj 2019

## Dallimet në mes të rekomandimeve të ekspertëve dhe vendimeve të panelit

Në 429 vendime që janë në favor të kompanive ankuese, eksperti ka dhënë rekomandim të kundërt në 124 raste ose 29% të tyre. Në 279 vendime të panelit që kanë qenë kundër kompanive ankuese, ekspertët kanë rekomanduar ndryshe në 91 raste ose 32.6% të tyre. Në përgjithësi vendimet e panelit dhe rekomandimet e ekspertëve nuk përputhen në 215 raste ose 30.4%.

Nga tabela më lartë vërehet se për ankesat ku ekspert ka qenë Basri Fazliu dhe Hysni Muhadri ka dallim të madh në mes të rekomandimit të dhënë dhe vendimit të panelit. Në disa raste numrat mes rekomandimeve të ekspertëve dhe vendimeve të panelit përputhen, por kjo nuk do të thotë që përputhja është 100% pasi ekspertët kanë mundur të kenë dhënë rekomandim pro OEA për ndonjë tender tjetër, ndërsa paneli ka vendosur pro OEA për tender tjetër.

Eksperti	Rekomandime pro OE	Rekomandime kundër OE	Vendime të panelit pro OE	Vendime të panelit kundër OE
Abetare Prebreza	18	13	18	13
Agim Sheqiri	22	10	23	9
Basri Fazliu	25	34	50	17
Bujar Sopi	15	15	15	15
Es'heme Beka	7	4	5	6
Hasim Krasniqi	29	23	30	20
Hysni Muhadri	20	24	26	18
Muhamet Kurtishaj	16	22	17	21
Nazmi Statovci	8	6	11	3
Qazim Hoxha	5	9	7	7
Safije Saramati	18	8	20	6
Sahit Beqiri	26	10	22	14
Teuta Krasniqi	5	6	8	3
Visar Basha	32	28	32	28
Visar Bibaj	39	16	36	19
Vjollca Balaj	7	4	8	3
Xhevdet Bushi	15	7	16	6

**TABELA 3:**


Rekomandimet pro dhe kundër OE sipas ekspertëve si dhe vendimet e panelit për ato rekomandime. Në tabelë janë paraqitur vetëm ekspertët që kanë se paku 10 rekomandime.

## Vonesat në vendimmarrje

Pas pranimit të ankesës OSHP ka 34 ditë kohë për të marrë vendim dhe për ta publikuar të njëjtin në uebfaqe. Prej 1 qershor 2018 e deri më 31 maj 2019 OSHP ka marrë 779 ven-

dime me kohë mesatare prej datës së ankesës deri në datën e publikimit prej 40 ditësh, e cila tejkalon afatin ligjor prej 34 ditëve. Krahasuar me vitet e kaluara, trendi i vonesave në vendimmarrje është në rritje. Kjo mund të lidhet me rritjen e numrit të ankesave dhe mungesës së dy anëtarëve të bordit.

### Koha mesatare e vendimmarrjes (në ditë)



**FIGURA 1**

Koha mesatare nga data e ankesës deri në datën e publikimit të vendimit, e ndarë sipas viteve. Në periudhën qershor 2018 – maj 2019 koha mesatare është 40 ditë

## Transparenca

Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, krahasuar me raportet e kaluara ka përmirësime. Është rrituri numri i seancave të hapura, probleme me qasje në dokumente nuk ka dhe arsyetimet e vendimeve janë më të detajuara. Mirëpo, siç përmendet edhe në raportet e kaluara të D+, problem vazhdon të mbetet publikimi i pjesshëm i ankesave dhe ekspertizave.

Në këtë periudhë në përgjithësi njoftimi i palëve është bërë me kohë. Megjithatë, në raste të kufizuara kanë ndodhur gabime tjera procedurale si për shembull emaili i dërguar në adresë të gabuar, duke shkaktuar mungesën e ndonjëres palë në seancë. Në anën tjetër, publikimi i njoftimeve për seanca në faqen e OSHP-së zakonisht bëhet me kohë, përveç në disa raste kur njoftimi publikohet ditën kur mbahet seanca. Kjo më shumë ndodhë për shkak të mënyrës se si është dizajnuar uebfaqja aktuale e cila në pjesën për njoftime për seanca nuk lejon vendosjen e më shumë se gjashtë njoftimeve, ndërsa ndonjëherë mbahen më shumë se gjashtë seanca brenda një dite. Megjithatë, mungesa e palëve në seancë qoftë për mosnjoftim, qoftë për arsye të panjohura nuk e pengon mbajtjen e seancës. Seanca shtyhet për mungesë të palëve vetëm në raste të rralla, sipas kërkesës së palëve drejtuar panelit. Në shumë raste mungojnë vetë ekspertët, praktikë kjo që është shpeshtuar gjatë vitit 2019. OSHP duhet të praktikojë ndaljen e pagesës për ekspertët e jashtëm që mungojnë në seancë, përveç në rastet kur mund ta arsyetojnë mungesën e tyre bindshëm.

Siç është theksuar edhe në raportet e kaluara të D+, mungesë të transparencës ka në publikimin e ankesave, ku publikohen vetëm dy faqet e para, të cilat nuk përmbajnë pikat ankimore të OE. Dokument tjetër jopublik mbetet edhe ekspertiza e cila i dorëzohet palëve dhe panelit. Edhe pse OSHP bën publikimin e vendimeve, formati elektronik i tyre është vështirë i lexueshëm nga kompjuteri dhe nuk lejon kërkimin brenda një vendimi për të gjetur më lehtë fjalët e kërkuara.

Në aspektin pozitiv, si rezultat i avokimit të vazhdueshëm nga D+, numri i seancave të hapura është rritur dhe kjo përbën rast për më shumë monitorim jo vetëm nga organizatat jo-qeveritare, por edhe mediat e qytetarët.

Po ashtu, gjatë këtij viti pritet që OSHP të ndryshojë uebfaqen për të ofruar më shumë mundësi për përdoruesit. Gjithashtu, transmetimi direkt i seancave të hapura me përkrahjen e projektit për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM) do të vazhdojë dhe do të zgjerohet më lansimin e uebfaqes së re.

## Rivlerësim, rivlerësim, rivlerësim

Nga më tepër se 1500 vendime të analizuara që nga janari 2017, D+ ka vërejtur se në disa vendime paneli nuk jep arsyetim të mjaftueshëm për pretendimet ankimore, duke hedhur përgjegjësinë përsëri tek AK përmes kthimit të tenderit në rivlerësim. Arsyetimet e zakonshme të panelit janë se nëse AK ka pyetje për ndonjë dokument, mund të kërkojë sqarime sipas nenit 59 dhe 72 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP). Paneli duke mos dhënë një përgjigje definitive për një pretendim ankimor, u jep mundësinë OE që përsëri të ankohen.

Një nga rastet ku paneli ka dhënë arsyetim të tillë është tenderi për pastrim dhe mirëmbajtje të rrugëve të komunës së Vitisë. Paneli kishte nxjerrë dy vendime dhe një urdhëresë për këtë tender. Në urdhëresën 448/18<sup>6</sup> ku ankues ishte El Bau kundër vendimit për anulim të tenderit nga komuna, një nga pretendimet ishte për cisternën e ujit me kapacitet 10,000 litra. Sipas panelit El Bau e kishte këtë cisternë, dëshmuar përmes librezës për qarkullim dhe disa fotografive. Paneli shtoi se nëse AK ka pyetje, mund të kërkojë sqarime.

AK zbatoi urdhëresën e OSHP-së dhe shpalli fitues El Bau. Megjithatë, kundër këtij vendimi u ankua OE Qendra Kop-shtare. Për pretendimin për cisternë, paneli vetëm përsëriti pretendimin e OE ankues, se El Bau nuk ka cisternë 10,000 litra por një mikser prej 8,300 kg që bëjnë 8,200 litra. Paneli nuk u përgjigj në pretendimin ankimor se a është cisterna sipas kërkesës apo jo por ofroi një arsyetim me fjalor të përgjithshëm se AK duhet të analizojë pretendimet e OE ankues dhe të bëjë vlerësimin e ofertave në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit<sup>7</sup>. Mirëpo në urdhëresë paneli kishte thënë se El Bau e plotësonte këtë kërkesë.

6 OSHP. Vendimi 448/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/448-18uzv.pdf>

7 OSHP. Vendimi 661/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/661-18vend.pdf>

Tenderi për furnizim me GPS i komunës së Gjakovës ka qenë katër herë në OSHP, tri herë është kthyer në rivlerësim, ndërsa herën e katërt është anuluar.<sup>8</sup> Në të gjitha ankesat, pretendimi i vetëm ankimor i kompanisë DWH Kosova ishte se OE i rekomanduar Ageo&Co, nuk kishte autorizim nga prodhuesi Hi Target. Eksperti shqyrtues, Visar Bibaj për katër ankesat e DWH Kosova rekomandoi rivlerësim. Në tri vendimet për rivlerësim, paneli obligoi AK që të kërkonte sqarime për autorizim, gjë të cilën AK e bëri. Në vendimin e tretë, urdhëresa 482/18 paneli konstatoi se komuna e Gjakovës ka kërkuar sqarime për autorizim në email [kyle@hi-target.com.cn](mailto:kyle@hi-target.com.cn) dhe [lukecao@hi-target.com.cn](mailto:lukecao@hi-target.com.cn). Përgjigje AK ka marrë nga emaili i dytë, ku thuhet se Ageo&Co është distributor i produkteve të Hi-Target që nga viti 2012. Por paneli gjithashtu shtoi se sipas faqes zyrtare, i vetmi email kontaktues është [sales@hi-target.com.cn](mailto:sales@hi-target.com.cn), ndërsa sipas panelit nuk mund të vërtetohej se Ageo&Co ishte i autorizuar. Mirëpo këtë vërtetim paneli ka mundur ta bëjë vetë që në vendimin e parë me ç'rast do të kursente kohën dhe rivlerësimet e vazhdueshme. Në vendimin e fundit paneli konstatoi se edhe ankuesi DWH Kosova ishte i papërgjegjshëm pasi formulari i tenderit nuk ishte nënshkruar nga personi i autorizuar. Si rezultat i ankesave të vazhdueshme dhe pas katër vendimeve për të verifikuar se a kishte autorizim Ageo&Co nga kompania Hi-Target apo jo, komuna e Gjakovës ka një vit që nuk arrin të blejë GPS-in që i nevojitet.

Paneli e ka të drejtën që të kërkojë sqarime për ndonjë dokument, ashtu siç ka vepruar për vendimin 80/19<sup>9</sup> për pretendimin e Liri Med se produkti i tyre e kishte normën e TVSH-së 0% (paneli ka kërkuar sqarime nga Dogana e Kosovës). Ngjashëm ka mundur të veprohet edhe me tenderin për komunën e Gjakovës që do të evitonte procesin një vjeçar të ankesës-rivlerësim-it-ankesës.

## Pretendimet e pabazuara, ankesat aprovohen

Në këtë periudhë të monitorimit janë marrë 779 vendime, ndër to vetëm 45 apo 5.78% janë ankesa të refuzuara. Nga tabela 1 vërehet se pikërisht për refuzim të ankesave ka dallim më të madh në mes të rekomandimeve të ekspertëve dhe vendimeve të panelit. Nga 203 rekomandime të ekspertëve për refuzim të ankesës, ku paneli po të vendoste njëjtë do të duhej të konfiskohej tarifa e ankesës, vendimi i panelit përputhet me rekomandimin e ekspertit vetëm në 40 raste.

Në disa vendime, edhe pse të gjitha pretendimet ankimore të ankuesve i ka refuzuar, OSHP-ja i ka aprovuar pjesërisht ankesat e tyre në mënyrë që të mos ju konfiskohej tarifa e ankesës. D+ ka identifikuar katër vendime ku paneli e ka bërë një gjë të tillë (654-655/18, 659/18, 681/18 dhe 170/19). Aprovim i ankesës vetëm që të mos konfiskohet tarifa i shtyen kompanitë që të ankohen më shumë kur e dinë që gjasat që ankesa të aprovohet pjesërisht janë shumë të mëdha. Në një rast tjetër paneli ka konfiskuar tarifën e ankesës<sup>10</sup>, kur në fakt ankesa e OE do të duhej të cilësohej si e pasafatshme. Kompania Sporting kërkesën për rishqyrtim e kishte bërë në ditën e 13-të, ndërsa afati ligjor është pesë ditë. Pasi nuk kishte pretendim tjetër, ankesa sipas Rregullores së Punës së OSHP-së<sup>11</sup> do duhej të cilësohej e pasafatshme dhe t'i kthehej tarifa OE ankues.

8 OSHP. Vendimi 701/18. 2019

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/701-18ven.pdf>

9 OSHP. Vendimi 80/19. 2019

<http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/80-19%20vend.pdf>

10 OSHP. Vendimi 362/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/362-18vendim.pdf>

11 OSHP. Rregullorja e Punës. Neni 33.4. 2017

[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/200-17-rregullorja\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/200-17-rregullorja_1.PDF)

# VENDIMET JOKONSISTENTE

Shumë ankesa kanë ngjashmëri mes vete për sa i përket pretendimit ankimorë. Kjo pasi që shumë institucione kryejnë veprime të kundërligjshme që janë të përsëritura edhe nga institucionet e tjera. Të tilla raste mund të konsiderohen shpërblimi me kontrata i kompanive të cilat kanë paraparë rroga të cilat bien në kundërshtim me rrogën minimale, apo nuk kanë kalkuluar pushimet vjetore të punëtorëve. Në këto raste, D+ vlerëson nëse OSHP i trajton me të njëjtin standard këto ankesa dhe në ato vendime ku vërehet se OSHP ka marr një vendim i cili është i kundërt me një paraprak, D+ e identifikon të njëjtin si vendim jokonsistent.

Në pjesën në vazhdim paraqiten raste të vendimeve jokonsistente për disa çështje. Jokonsistenca ka ndikime negative në shumë dimensione duke përfshirë krijimin e pasigurisë juridike në prokurim publik, humbjen e besimit të palëve në OSHP dhe rritjen e dyshimeve për anësi në trajtimin e lëndëve nga ekspertët dhe paneli.

## Vendimet për pagë neto/bruto

Siç ceket edhe në raportin e D+ "Interpretimi rast pas rasti i Ligjit të Prokurimit Publik"<sup>12</sup>, OSHP merr numër të konsiderueshëm të vendimeve që janë kundërtë nëse në mes vete në lidhje me ankesat për respektim të Ligjit të Punës. Në këtë periudhë monitoruese janë identifikuar 26 sosh ku një nga pretendimet ankimore të OE ka qenë mosrespektimi i Ligjit të Punës. Çështja është nëse OSHP duhet të marrë parasysh pretendimet ankimore për mosrespektim të Ligjit të Punës edhe kur në dosje të tenderit nuk kërkohet që të respektohet ky ligj.

Përderisa OSHP për mosrespektim të tarifave të BQK për sigurim të automjeteve në vendimin 324/18<sup>13</sup> ka vendosur që tenderi të kthehet në rivlerësim, edhe pse në dosje të tenderit këto tarifa nuk ishin kërkuar që të respektoheshin, ka vendosur një precedent i cili mund të kuptohet se edhe nëse një ligj apo rregullore nuk kërkohet në dosje të tenderit, paneli mund të kërkojë që të respektohet.

Mosrespektimi i Ligjit të Punës dhe pagës minimale bën që punëtorët të punojnë në kushte të vështira, me orar të punës të stërzgatur dhe pagesë për orë nën minimumin e llogaritur sipas pagës minimale. Edhe në rastet kur kërkesa për respektim të Ligjit të Punës ka qenë pjesë e dosjes së tenderit dhe kur është caktuar paga në dosje, ekspertët dhe paneli kanë pasur probleme në llogaritje bazike për të parë se a arrin OE ankues ose i rekomanduar që të kryejnë obligimet ndaj punëtorëve me çmimin e ofruar. Elementet që hyjnë në llogaritje janë: paga (bruto ose neto), tatimi në pagë dhe kontributi pensional i të punësuarit dhe punëdhënësit. Në bazë të Ligjit të Punës, neni 56.2 mbi pagën bazë bëhen edhe këto pagesa<sup>14</sup>:

12 Demokraci Plus. Interpretimi rast pas rasti i Ligjit të Prokurimit Publik. 2019 <http://www.dplus-ks.org/wp-content/uploads/2019/07/05-Raporti-i-monitorimit-te-OSHP-ALB-04.pdf>

13 OSHP. Vendimi 324/18. 2018 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/324-18vend.pdf>

14 Ligji Nr. 03/L-212 i Punës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2010. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

**2** TË PUNËSUARIT I TAKON PAGA SHITESË NË PËRQINDJE TË PAGËS BAZË, SI MË POSHTË:

**2.1** **20%**  
NË ORË PËR KUJDESTARI;

**2.2** **30%**  
NË ORË PËR PUNË GJATË NATËS;

**2.3** **30%**  
NË ORË PËR PUNË JASHTË ORARIT;

**2.4** **50%**  
NË ORË PËR PUNË GJATË DITËVE TË FESTAVE; DHE

**2.5** **50%**  
NË ORË PËR PUNË GJATË FUNDJAVËS.



Llogaritjet në bazë të vlerave më lartë nuk i bëjnë as ekspertët e as paneli.

*Paga neto + tatimi në pagë + kontributi pensional i të punësuarit + kontributi pensional nga punëdhënësi + pagesa shtesë në bazë të nenit 56.2 përbëjnë shpenzim për OE.*

Ky është një prag dhe ofertat nën të konsiderohen me automatizëm se janë me çmim jonormalisht të ulët. Ekspertët shqyrtues që kanë shkollim në fushat e ekonomisë nuk do të duhej të kishin problem një llogaritje të tillë të thjeshtë matematikore. Për më tepër, në rastet kur ekspertët nuk janë të sigurtë në këto përlogaritje, do të duhej të konsultoheshin me Inspektoratin e Punës në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, siç parashihet në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative<sup>15</sup>.

D+ thekson nevojën që OSHP t'i kushtojë një vëmendje më të madhe shkeljeve të ligjeve të veçanta në çdo rast që diçka e tillë identifikohet. Në rastet kur OSHP e konsideron veten jokompetente, t'i referoj këto çështje në institucionet përkatëse, por në asnjë mënyrë këto raste të mos mbesin të patrajuara. Për më tepër edhe në Kushtet e Përgjithshme të dosjeve të tenderit theksohet që OE duhet të veprojë sipas ligjeve në fuqi në Kosovë. Neni 7.3 i Dosjes së Tenderit për Furnizim thotë:

**“**  
**7.3 FURNIZUESI DUHET T'I RESPEKTOJË DHE TË VEPROJË SIPAS TË GJITHA LIGJEVE DHE RREGULLOREVE NË FUQI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE TË SIGUROJË QË PERSONELI I TIJ, TË AFËRMIT E TYRE, DHE PUNËTORËT VENDORË TË TIJ GJITHASHTU T'I RESPEKTOJNË DHE TË VEPROJNË SIPAS KËTYRE LIGJEVE DHE RREGULLOREVE<sup>16</sup>.**

15 Neni 34, Ndihma administrative: 1. Organi publik mund t'i kërkojë ndihmë (në vijim "ndihma administrative") një organi tjetër publik, për kryerjen e një a disa veprimeve të nevojshme procedurale, në kuadër të një procedure administrative. 2. Ndhma administrative kërkohet: 2.1. nëse për arsye të justifikuara, organi kërkues, nuk mund t'i kryejë vetë këto veprime; 2.2. nëse kryerja e veprimeve nga organi kërkues nuk është efektive apo kostot për kryerjen e tyre janë shumë më të larta në krahasim me koston e kryerjes së tyre nga organi tjetër; 2.3. për njohjen me fakte, dokumente apo mjete të tjera të provës në posedim të organit tjetër; 3. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, organi publik mund ta zgjedhë organin, të cilit i kërkon ndihmë, në përputhje me parimin e kosto-efektivitetit.

16 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. B15 Dosja e Tenderit – Furnizim – Procedura e hapur. 2016. <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/B15.docx>





Njëjtë thotë edhe neni 8.2 i Kushteve të Përgjithshme për Dosjen e Tenderit – Punë.

Më poshtë paraqiten disa nga vendimet ku ka jokonsistencë në lidhje me respektimin e Ligjit të Punës.

### Rojet e Nderit v. Prokuroria e Shtetit, 415/18

Në tenderin “Sigurimi fizik i objekteve të Sistemit Prokurorial të Kosovës” paneli vendosi që tenderi të kthehet në rivlerësim me arsyetimin që AK duhet të vërtetojë se a mundet OE fitues me çmimin e ofruar t’i paguajë punëtorët sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë<sup>17</sup>. Ky vendim i OSHP-së ishte nxjerrë edhe pse diçka e tillë nuk ishte kërkuar në dosje të tenderit. Eksperti shqyrtues Hasim Krasniqi dha rekomandim që ankesa të refuzohet pasi AK nuk kishte kërkuar në dosje të tenderit që të respektohet Ligji i Punës.

Pas rivlerësimit AK prapë shpalli fitues të njëjtin OE, ndërsa OE Rojet e Nderit u ankua përsëri. Paneli ktheu tenderin në rivlerësim edhe njëherë<sup>18</sup>, por dha arsyetim kundërthënës. Përderisa në vendimin e parë kishte thënë që AK të vërtetojë se a mundet OE fitues t’i paguajë punëtorët me çmimet e ofruara, në vendimin e dytë tha që në dosje të tenderit nuk është kërkuar që të respektohet Ligji i Punës dhe paga minimale. Në të njëjtin vendim dy paragrafë më lartë paneli u arsyetua se nuk është respektuar vendimi i kaluar.

Eksperti shqyrtues ndryshoi rekomandimin e tij në vendimin e dytë duke rekomanduar që të aprovohet pjesërisht ankesa dhe tenderi të kthehet në rivlerësim. Përderisa në vendimin e parë paneli kishte thënë që Ligji i Punës dhe paga minimale nuk janë kërkuar të respektohen, në vendimin e dytë duke u bazuar në arsyetimin e panelit që kishte dhënë në vendimin e parë, deklaroi që AK nuk ka vërtetuar se a mundet OE fitues t’i paguajë punëtorët me çmimin e ofruar. Në fakt, në vendimin e dytë, rekomandimi i ekspertit dhe arsyetimi i panelit kanë tekst të njëjtë.

17 OSHP. Vendimi 415/18. 2018.

[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/415-18vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/415-18vendim_1.PDF)

18 OSHP. Vendimi 627/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/627-18vend.pdf>

19 OSHP. Vendimi 138/19.

2019 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/138-19vend.pdf>

Pas rivlerësimit Prokuroria e Shtetit anuloi tenderin me arsyen se të gjitha ofertat janë të papërgjegjshme.

### Luani v. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 138/19

Në një vendim tjetër, paneli nuk e aprovoi pretendimin ankimor të kompanisë Luani për mosrespektim të Ligjit të Punës duke e cilësuar që nuk ka qenë kërkesë në dosje të tenderit që të respektohet Ligji i Punës<sup>19</sup>. Të njëjtin mendim e kishte edhe eksperti shqyrtues, Hysni Muhadri.

Ky vendim është kundërthënës me vendimin për Prokurorinë e Shtetit, pasi paneli në atë rast ka aprovuar ankesën e OE ankues edhe pse nuk ishte kërkuar që të respektohet Ligji i Punës. Ndërsa në vendimin 138/19 paneli refuzoi ankesën pasi në dosje të tenderit nuk ishte kërkuar që të respektohet ky ligj.

## Vendimet për tejkalim të buxhetit të planifikuar

Kontrata kornizë përdoret kur AK nuk e di sasinë e saktë të produkteve që do të blejë dhe ky lloj i kontratës mundëson që sasinë e kontratës të shtohen apo ulen deri në 30% përgjatë zbatimit të kontratës, varësisht nga nevoja e AK. Megjithatë edhe për kontratën kornizë jepet vlera e parashikuar e cila është një kufi mbi të cilën AK mund të mos i pranojë ofertat, sipas të drejtës që ia jep neni 62 i LPP-së. Në disa raste OSHP ka kthyer tenderët në rivlerësim edhe pse ofertat e OE ankues tejkalonin dukshëm vlerën e parashikuar. Arsyetimi i panelit në një vendim është që pasi është kontratë kornizë, AK mund të mos shpenzojë të gjithë vlerën e parashikuar dhe në momentin e shpenzimit të vlerës së parashikuar kontrata do të ndërpritet. Në disa vendime tjera paneli ka refuzuar ankesën por nuk ka përdorur të njëjtin arsyetim.

### Bojku Hidraulik v. KEK, 555/18

Tenderi "Furnizim me pjesë ndërrimi për mekanizmin Iveco", ishte anuluar nga KEK, pasi oferta e Bojku Hidraulik ishte 452,777 euro, ndërsa vlera e parashikuar ishte 360,000 euro. Dallimi në çmim ishte 92,777 euro apo 25.77% më i lartë. Bojku Hidraulik u ankua në OSHP me pretendimin se ishte shkelur neni 56.10 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (tutje Udhëzuesi) që ka të bëjë me kontratën kornizë. Paneli aprovoi ankesën dhe ktheu tenderin në rivlerësim<sup>20</sup>. Arsyetimi i panelit ishte që pasi është kontratë kornizë AK nuk është e detyruar t'i shpenzojë të gjitha mjetet dhe nëse tejkalohe vlera e parashikuar kontrata ndërpritet automatikisht, ashtu siç thotë neni 56.10 i Udhëzuesit. Paneli gjithashtu vuri në pah rëndësinë e këtij tenderi, por pa dhënë ndonjë shpjegim të detajuar.

Eksperti shqyrtues Visar Bibaj, duke u mbështetur në nenin 62 të LPP-së, rekomandoi që ankesa të refuzohet pasi OE ankues kishte tejkeluar vlerën e parashikuar.

Pas rivlerësimit, KEK përsëri anuloi tenderin me arsyetimin që nuk ka oferta të përgjegjshme. Kundër këtij vendimi përsëri u ankua Bojku Hidraulik, ndërsa OSHP përveçse aprovoi ankesën, lëshoi edhe urdhëresë pasi AK nuk e kishte zbatuar vendimin 555/18<sup>21</sup>. Paneli dha arsyetim të njëjtë në lidhje me mosrespektimin e nenit 38 të LPP-së që flet për kontratën kornizë. Si rezultat i urdhëresës AK nënshkroi kontratën me Bojku Hidraulik.

Me interpretimin që OSHP i bën kontratës kornizë për këtë tender, AK do të paguajë më tepër se sa vlera që ka parashikuar. Në kontratë thuhet që AK do të porosisë produkte për aq sa ka qenë buxheti i planifikuar, në bazë të urdhëresës së dhënë nga OSHP. Mirëpo neni 56.10 i Udhëzuesit thotë që devijimi prej plus/minus 30% lejohet për sasi të totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës, por jo për vlerën e parashikuar të kontratës.

20 OSHP. Vendimi 555/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/555-18vend.pdf>

21 OSHP. Vendimi 751/18. 2019  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/751-18vend.pdf>

22 OSHP. Vendimi 724/18. 2019  
[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/724\\_18%20vendim.pdf](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/724_18%20vendim.pdf)

23 OSHP. Vendimi 404/17. 2017  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/404-17%20vendim.pdf>

### ICN & BM v. Ministria e Shëndetësisë, 724/18

Në vendimin 724/18 paneli vendosi që të vërtetohet anulimi i tenderit nga AK pasi OE kishte tejkeluar vlerën e parashikuar për 130%<sup>22</sup>. Sikur në tenderin e KEK edhe ky tender ishte kontratë kornizë. Edhe pse kompania ankuese nuk e kishte pretendim ankimor nënin 38 të LPP, paneli ka mundur ta ketë parasysh këtë dhe të vendosë njëjtë si në vendimin 555/18. Paneli në këtë rast është bazuar në nenin 62 që lejon anulimin e tenderit për tejkalim të buxhetit. Në vendimin për KEK tejkalimi ishte i dukshëm e për më tepër neni 62 lejon në diskrecion të AK që ta pranojë një ofertë mbi vlerën e parashikuar.

Një AK mund të keq planifikojë vlerën e parashikuar të tenderit, por nuk mund të detyrohet të lidhë kontratë mbi atë vlerë. Interpretimi i OSHP-së për kontratën kornizë potencialisht mund të hapë rrugë për oferta me çmime shumë të larta. Këto kompani pasi do të eliminohehin do të ankoheshin në OSHP për shkelje të dispozitave ligjore në lidhje me kontratën kornizë. Aprovimi i ankesave të tyre do të mundësonte që këto kompani të fitojnë tenderin përmes vendimeve të OSHP, ndërsa kontrata të zbatohet për aq sa ka buxhet AK. Kjo i përshtatet kompanive pasi vlera e kontratës është më e vogël në atë rast por çmimet për njësi mbesin të njëjta.

### Liri Med v. Ministria e Shëndetësisë, 404/17

Një krahasim më i drejtpërdrejtë mund të bëhet për vendimet 724/18 dhe 404/17 (dhe dy vendimet tjera të mëvonshme), të dyja për tender të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) për furnizim me barna nga lista esenciale. Në vendimin 404/17 paneli aprovoi pretendimet e Liri Med duke e kthyer tenderin në rivlerësim për lotet të cilat ishin anuluar për tejkalim të buxhetit<sup>23</sup>. Gjithashtu arsyetim tjetër i panelit ishte se Liri Med ka ofruar dëshmi se çmimet e ofruara janë çmime të tregut, ndërsa paneli kërkoi nga AK që të bëjë hulumtimin e tregut. Eksperti shqyrtues, Muhamet Kurtishaj gjithashtu rekomandoi të rivlerësohej tenderi pasi që sipas tij kishte buxhet të mbetur sepse nuk ishin nënshkruar kontrata për të gjitha lotet. Megjithatë eksperti nuk pati parasysh që AK kishte dhënë vlerën e parashikuar për lot.

Pas rivlerësimit AK përsëri anuloi lotet me arsyen e njëjtë (tejkallim të vlerës së parashikuar) dhe Liri Med u ankuar sërish. Këtë herë eksperti ndryshoi mendimin e tij pa dhënë ndonjë arsytim, duke thënë që qëndron pretendimi që ka mbetur buxhet, mirëpo Zyrtaari Kryesor Administrativ (ZKA) nuk ka aprovuar buxhet shtesë. Me faktin që AK ka anuluar tenderin nënkuptohet që ZKA nuk ka aprovuar buxhet shtesë që në herën e parë, përndryshe po të aprovonte buxhetin shtesë, atëherë fitues i kontratës do të ishte Liri Med. Në rekomandimin e parë eksperti ceku gjithashtu interesin publik, ndërsa në të dytin u bazua në arsyen se AK nuk mund të hyjë në obligime kontraktuale pa buxhet të mjaftueshëm. Eksperti do të duhej të jepte arsytim se përse e ndërroi qëndrimin në dy rekomandimet e tij. Paneli përsëri vendosi që të aprovohet ankesa dhe tenderi të kthehet në rivlerësim<sup>24</sup> duke u arsyetuar se AK nuk ka bërë hulumtimin e tregut dhe duke shtuar se kishin mbetur edhe rreth 700,000 euro buxhet nga totali i planifikuar.

Pas rivlerësimit, AK e anuloi tenderin përsëri duke shtyrë Liri Med që të bëjë ankesë përsëri. Duke rënë në kundërshtim me vendimin 404/17 dhe 82/18, paneli anuloi tenderin me arsyen se AK ka ofruar dëshmi se çmimet e Liri Med janë më të larta se çmimet e tregut<sup>25</sup>. Eksperti Muhamet Kurtishaj këtë herë dha rekomandim që ankesa të refuzohet me arsyen se është tejkalluar buxheti i planifikuar. Paneli në vendimin e fundit u arsyetua se AK ka bërë analizë të çmimeve të tregut dhe me të drejtë ka anuluar tenderin, por prapë obligoi AK që të bëjë parashikim të saktë të çmimeve, gjë që AK e kishte bërë pasi që çmimet e Liri Med ishin shumë të larta (shih tabelën e mëposhtme).

Kundërthënie tjetër është se në vendimin 404/17 paneli tha se Liri Med ka ofruar prova se çmimet e ofruara janë çmime të tregut. Në vendimin 306/18 paneli tha se AK ka dhënë dëshmi se çmimet e Liri Med nuk janë çmime të tregut. Pra nuk mund të jetë logjike që të dy palët të kenë të drejtë, duke marrë parasysh dallimin e madh në mes të vlerës së parashikuar dhe çmimit të ofruar.

## VENDIMET

404/17

DHE

82/18

BIEN NË KUNDËRSHTIM TË DREJTPËRDREJTË ME VENDIMIN

724/18

KU PANELI REFUZOI ANKESËN E ICN&amp;BM ME ARSYETIMIN QË KA TEJKALLIM TË BUXHETIT.

Duke u mbështetur në të dhënat e nxjerra nga databaza e vendimeve të OSHP-së<sup>26</sup>, janë 11 vendime në dy vitet e fundit ku OSHP ka kthyer tenderin në rivlerësim edhe pse ka pasur tejkallim të buxhetit. Nga këto 11 vendime, pesë janë për ankesat e Liri Med.

Këto dy vendime përveç që kanë jokonsistencë të madhe, mund të cilësohen që nuk është bërë trajtim i barabartë i OE. Tenderët për të cilat janë ankuar Liri Med dhe ICN&BM kanë shumë të përbashkëta: të dy tenderët janë kontratë kornizë, të dy e kanë të dhënë vlerën e parashikuar për lot, në të dy tenderët ofertat e kompanive kishin tejkalluar vlerën e parashikuar për lot si dhe të dy kompanitë pretendonin se çmimet e tyre janë çmime të tregut. Megjithatë vendimi për Liri Med ishte rivlerësim, ndërsa për ICN&BM refuzim.

24 OSHP. Vendimi 82/18. 2018

[http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/82-18vendim\\_1.PDF](http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/82-18vendim_1.PDF)

25 OSHP. Vendimi 306/18. 2018

[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/306-18vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/306-18vendim_1.PDF)

26 Demokraci Plus. Databaza e vendimeve të OSHP. Qasur më 1 qershor 2019.

<http://oshp.dplus-ks.org/vendimet>

	Lot	Vlera e parashikuar (Në Euro)	Oferta (Në Euro)	Tejkalimi i vlerës së parashikuar (Në %)
ICN&BM	23	4,010	9,624	140
Liri Med	6	36,036	117,936	227
	8	10,880	29,376	170
	9	20,700	136,800	560
	12	492	53,136	10700
	16	190,320	198,806	4.46
	34	1,950	22,950	1076
	39	32,340	95,515	195
	40	10,400	34,560	232

**TABELA 4:** Vlera e parashikuar, ofertat e kompanive dhe tejkalimi i buxhetit në përqindje

## Tejkalim buxheti – trajtim i pabarabartë

Më poshtë paraqiten raste kur është tejkuluar buxheti, por në këto vendime për dallim nga ato më lartë, është përfshirë edhe elementi i trajtimit të pabarabartë të OE nga AK.

### Liri Med v. Ministria e Shëndetësisë, 113/18

Siç u përmend më lartë, janë disa vendime ku paneli i ka aprovuar ankesat e Liri Med që kanë të bëjnë me tejkalimin e buxhetit. Në rastin e vendimit 113/18 situata është pak më ndryshe. Në një tender tjetër për furnizim me barna nga lista esenciale, Liri Med kishte tejkuluar buxhetin për lotet 4, 8, 10, 17, 19, 20. Pasi nuk kishte oferta tjera, AK anuloi tenderin me arsyen se është tejkuluar buxheti i planifikuar. Liri Med u ankua në OSHP e cila aprovoi ankesën duke u mbështetur në parimin e trajtimit jo të barabartë<sup>27</sup>. AK për lot 12 ku kishte fituar kompania Santefarm kishte aprovuar buxhet shtesë, pasi oferta ishte për 8% më e lartë se vlera e parashikuar.

Këtë paneli e cilësoi si diskriminim dhe trajtim i pabarabartë ndaj Liri Med.

### Medica v. Ministria e Shëndetësisë, 41/19

Për një tender tjetër, furnizim me pajisje mjekësore, paneli vendosi ndryshe<sup>28</sup>. Pretendimi i OE Medica ishte që AK për një lot tjetër kishte aprovuar buxhet shtesë, ndërsa lotin 3 ku kishte ofertuar Medica e kishte anuluar. Mirëpo në pesë lote tjera AK kishte aprovuar buxhet shtesë. Paneli në arsyetim (i cili është fjalë për fjalë i njëjtë me rekomandimin e ekspertit) tha që OE Medica ka tejkuluar vlerën e parashikuar dhe ZKA nuk ka aprovuar buxhet shtesë. Paneli po ta kishte parasysht vendimin për Liri Med mund të vendoste njëjtë edhe për Medica. Këto dy vendime përveçse janë jokonsistente, mund të interpretohen edhe se OSHP po favorizon kompaninë Liri Med pasi në dy raste i është aprovuar ankesa, ndërsa për të njëjtën çështje kompanive tjera ju është refuzuar.

<sup>27</sup> OSHP. Vendimi 113/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/113-18vend.pdf>

<sup>28</sup> OSHP. Vendimi 37-41-43-44/19. 2019  
<http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/37-41-43-44-19vend.pdf>



Çdo herë kur pretendimi është për tejkalim buxheti, paneli do të duhej të refuzonte ankesat, pasi siç e ka arsyetur edhe vetë në vendimin 41/19:

*“Megjithatë konform nenit 62, përkatësisht paragrafit 1.2 të LPP-së, është kompetencë e AK-së anulimi i aktivitetit të prokurimit në rast se të gjithë tenderët përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e AK-së për aktivitetin e prokurimit.”*

Përmes kthimit në rivlerësim, siç e pamë më lartë në vendimin për Liri Med, paneli vetëm sa ka humbur kohë pasi AK përsëri e ka anuluar tenderin. AK mund të ketë gabuar në parashikim të buxhetit dhe në këtë rast OSHP mund të kishte urdhëruar që të anulohet tenderi, por jo që ai të kthehet në rivlerësim.

## Vendimet për ankesat në kritere të dosjes së tenderit

Shpesh ndodh që AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit të vendosin kritere që janë favorizuese për një prodhues të caktuar, ose në rastin më të keq të kërkojnë produkt specifik të një prodhuesi pa e shtuar fjalën “ekuivalent”. Ankesat ndaj kritereve të dosjes së tenderit duhet të bëhen së paku pesë ditë para hapjes së ofertave, siç e përcakton neni 108/A i LPP-së.

### Carpel v. Kuvendi i Kosovës, 14/18

Kompania Carpel ishte ankuar në OSHP kundër vendimit që Kuvendi i Kosovës kishte marrë për t'i dhënë kontratën kompanisë Gjini. Carpel pretendonte që specifikat teknike të dosjes së tenderit i ishin përshtatur kompanisë Gjini në masën 100%, duke u mbështetur në nenin 28 të LPP-së i cili thotë se ndalohet që AK të hartojë specifika të cilat favorizojnë ndonjë prodhues të caktuar. AK këtë mund ta bëjë vetëm nëse shton edhe fjalën “ekuivalent”. Eksperti shqyrtues Visar Basha tha se për këtë

Carpel është dashur të bëjë ankesë para hapjes së ofertave, bazuar në nenin 108/A të LPP-së, dhe nuk shqyrtoi fare pretendimin ankimor për përshtatje të kritereve, por vetëm rekomandoi refuzimin e ankesës.

Me mendimin e ekspertit u pajtua edhe paneli i cili vendosi të refuzohet ankesa, pasi për ankesë në kritere, Carpel është dashur që këtë ta bëjë para hapjes së ofertave<sup>29</sup>. Me këtë vendim OSHP vendosi standardin e mos trajtimit të ankesave kundër specifikave teknike të tenderit nëse ato nuk janë bërë brenda afatit ligjor prej pesë ditësh para hapjes së ofertave.

### DWH Kosova v. Komuna e Gjilanit, 241/18

Në ankesën e DWH Kosova kundër vendimit që Komuna e Gjilanit të shpërblejë me kontratë OE Ageo&Co, paneli mori vendim jokonsistent me vendimin 14/18 pasi vendosi që tenderi të anulohet<sup>30</sup>. DWH Kosova ishte ankuar për kriteret e dosjes së tenderit me arsyen që specifikat teknike kanë qenë të përshtatura për një kompani, por këtë e kishte bërë pas hapjes së ofertave dhe pasi fitues ishte zgjedhur kompania Ageo&Co.

Eksperti Abdurrahman Çunaku rekomandoi që tenderi të anulohet pasi AK në specifika kishte përdorur emër të një prodhuesi, e sipas tij kjo binte ndesh me nenin 28 të LPP-së. AK pranoi që në pozicionin për bateri kanë kërkuar emër të prodhuesit, pasi vetëm ajo bateri e plotësonte pajisjen që AK ishte duke e përdorur. Paneli vendimin e arsyetoi se është shkelur neni 28.7 i LPP-së, i cili në fakt nuk ishte shkelur pasi nuk mundet një bateri e një prodhuesi tjetër të përshtatet me pajisjen që ishte në përdorim nga komuna. Megjithatë, paneli po të përdorte arsyetimin sipas nenit 108/A do të duhej që ta vërtetonte vendimin e AK për dhënien të kontratës pasi DWH Kosova nuk ishte ankuar në kritere para hapjes së ofertave.

Që nga janari i vitit 2017 OSHP ka marrë 10 vendime ku një nga pretendimet ankimore të OE ka qenë për kritere të dosjes së tenderit, por ankesat janë bërë pasi janë hapur ofertat. Vetëm në vendimin për DWH Kosova është aprovuar ankesa, ndërsa në nëntë ankesa tjera ky pretendim është cilësuar i pabazuar. Ekziston mundësia që paneli ka mundur të ndikohet nga eksperti në këtë rast, pasi në nëntë ankesat tjera ekspertët pretendimin për përshtatje të kritereve e kanë cilësuar si të pabazuar.

<sup>29</sup> OSHP. Vendimi 14/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/14-18vendim.pdf>

<sup>30</sup> OSHP. Vendimi 241/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/241-18vend.pdf>

## Vendimet për tenderët jonormalisht i ulët

Vendime jo konsistente janë identifikuar edhe për tenderët jo normalisht të ulët, të cilët janë shumë të shpeshtë në aktivitetet e prokurimit publik. Çështja kontestuese në këtë rast mbetet se a lëshohet ose jo OSHP në vlerësimin e çmimeve nëse janë në përputhje me ato të tregut. Sipas nenit 61 të LPP-së një tender mund të cilësohet si jonormalisht i ulët nëse kalkullohet sipas formulës që gjendet në nenin 3.1 të rregullorës për tender jonormalisht të ulët<sup>31</sup> të miratuara nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP). Por sipas nenit 3.2 të kësaj rregulloreje, një tender mund të cilësohet si jonormalisht i ulët edhe për arsye tjera. Megjithatë në të dy rastet tenderi nuk mund të refuzohet pa kërkuar sqarime nga ofertuesi për çmimet e ofruara. Nëse AK pajtohet me shpjegimet atëherë pranon ofertën, nëse jo, tenderi refuzohet si jonormalisht i ulët. Në disa vendime paneli nuk ka një qëndrim të njëjtë se a është përgjegjësi e AK vlerësimi i çmimeve të tenderit, a duhet të përdoret formula apo jo dhe a duhet të lëshohet OSHP në vlerësim se shpjegimi i ofruar nga ofertuesi është bindës apo jo.

Paneli në arsyetim të vendimit 26-27/18<sup>32</sup>, ka konfirmuar se vlerësimi i çmimeve është e drejtë e AK-së dhe përgjegjësia bie mbi AK-në për të trajtuar një tender apo pozicion të tenderit si jonormalisht të ulët. Mirëpo ky arsyetim i panelit nuk është përdorur në vendime tjera.

Në vendimin 178/18 paneli ktheu tenderin në rivlerësim në mënyrë që të verifikohen çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar se a janë çmime reale të tregut<sup>33</sup>. AK zgjodhi fitues kompaninë Blendi, e cila sipas formulës kishte tender jonormalisht të ulët. AK kishte kërkuar sqarime për çmimet e dhëna nga OE Blendi dhe ishte bindur me sqarimet. Arsyetimi i panelit mund të kuptohet se edhe nëse AK bindet nga sqarimet e operatorëve ekonomik mundet që kjo mos të merret parasysh nga paneli.

Në një vendim tjetër me të njëjtat karakteristika, pra ku AK ka pasur dyshime për çmimet e fituesit, ka kërkuar sqarime dhe është bindur nga ato, paneli mori vendim tjetër. Ankesa e OE Auto Beka u refuzua me arsyen se AK ishte bindur me sqarimet e dhëna nga fituesi Universal Commerce<sup>34</sup>. Për këta dy tenderë mund të shihet se paneli vetëm vlerësoi bindjen e AK ndaj çmimeve të fituesit dhe nuk u lëshua në vlerësim të tenderit sipas formulës për tender jonormalisht të ulët.

Në një vendim tjetër paneli ktheu tenderin në rivlerësim dhe obligoi AK që të përdorë formulën për tender jonormalisht të ulët<sup>35</sup>. AK kishte përdorur nenin 3.2 të formularit B57 i cili thotë:

“

**3.2 KUR TENDERËT DUKEN TË JENË JONORMALISHT TË ULËT PËR ARSYE TË TJERA NGA ATO TË PARASHIKUARA NË PARAGRAFIN 3.1 TË KËTYRE RREGULLAVE, AUTORITETET KONTRAKTUESE MUND TË VLERËSOJNË BESUESHMËRINË E TENDERËVE TË TILLË DHE RRJEDHIMISHT TË KËRKOJNË SHPJEGIME NË PËRPUTHJE ME PARAGRAFËT E MËPOSHTËM DHE NENIN 61 TË LPP-SË.**

31 B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët- Verzioni i korrigjuar. Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik. [https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/Rregullat%20per%20Tenderet%20Jo-Normalisht%20te%20Ulet\\_v2\\_07\\_07\\_2016.docx](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/Rregullat%20per%20Tenderet%20Jo-Normalisht%20te%20Ulet_v2_07_07_2016.docx)

32 OSHP. Vendimi 26-27/18. 2018.

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/26-27-18vendim.pdf>

33 OSHP. Vendimi 178/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/178-18vendim.pdf>

34 OSHP. Vendimi 202/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/202-18vend.pdf>

35 OSHP. Vendimi 285/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/285-18vend.pdf>

Pasi tenderi i OE të rekomanduar nuk arrinte kriterin të cilëssohet si jonormalisht i ulët sipas formulës, AK kishte shfrytëzuar nenin 3.2 për ta eliminuar. OE i rekomanduar kishte dhënë çmime jonormalisht të ulëta për gjashtë produkte: capuccino 0.01 euro, qumësht me çokolatë 0.01 euro, omlet me djath 0.1 euro, sendviç me djath/kaçkavall/suxhuk 0.05 euro. Këto çmime lehtësisht vërehen se janë jonormalisht të ulëta dhe nuk janë çmime të tregut. Kur nuk arrihet që një tender të cilëssohet si jonormalisht i ulët në bazë të formulës për arsye të ndryshme (psh. nuk janë tri oferta të përgjegjshme) atëherë është pikërisht neni 3.2 që mund të përdoret.

Në një rast tjetër paneli u arsyetua se është e drejtë e AK vlerësimi për çmim jonormalisht të ulët, pa bërë ndonjë llogaritje vet<sup>36</sup>. Paneli në arsyetim citoi nenin 1 të rregullave për çmim jonormalisht të ulët (formulari B57), i cili thotë:

“

**1.1 QËLLIMI I KËTYRE RREGULLAVE ËSHTË QË TË JEPEN SQARIME PËR AUTORITETET KONTRAKTUESE NË LIDHJE ME KONCEPTIN E TENDERIT JO-NORMALISHT TË ULËT I CILI I REFEROHET ATYRE TENDERËVE QË, NË SHIKIM TË PARË, DUKEN PËR AUTORITETIN KONTRAKTUES SI JO TË BESUESHËM NËSE KRAHASOHET ME OBJEKTIN E KONTRATËS DHE, NË PËRPUTHJE ME RRETHANAT, KA GJASA PËR NJË PERFORMANCË TË KEQE TË KONTRATËS.**

Nga vendimet e përmendura më lartë mund të shihet se paneli nuk merr vendime konsistente për një problem madhor siç janë tenderët me çmim jonormalisht të ulët. Nga të gjitha vendimet, këto për çmim jonormalisht të ulët janë më të vështirat për t'u parashikuar. Paneli, pa ndonjë arsyetim mund të vendosë se arsyetimi i një OE nuk ka qenë bindës, ose nuk është përdorur formula, ose të përdoret formula kur

OE është eliminuar në bazë të nenit 3.2 të rregullores ose që vlerësimi i çmimit është e drejtë e AK.

OSHP do të duhej që për pretendimet për tender jonormalisht të ulët të marrë një qëndrim konsistent. Nëse vlerësohet se vlerësimi i tenderit është e drejtë e AK-së, atëherë në të gjitha vendimet për këtë çështje duhet të përdoret po ky arsyetim. Mirëpo kjo mund të jetë e rrezikshme pasi jo çdo herë AK i shohin çmimet nga një cent si çmim jonormalisht i ulët. Në disa raste OSHP e ka bërë vetë vlerësimin e çmimeve dhe sipas D+ kjo është mënyra më e mirë për t'i trajtuar pretendimet për tender jonormalisht të ulët. Ekspertët shqyrtues dhe paneli do të duhej të vlerësonin tenderin se a është jonormalisht i ulët apo jo, e jo ta konsiderojnë atë si të drejtë e AK. E drejtë e AK është edhe aprovimi i buxhetit shtesë kur ka tejkalim të buxhetit, por siç u cek më lartë këtë të drejtë në disa raste OSHP nuk e ka njohur.

## Vendimet për vërtetimin se kompanitë nuk kanë borxhe ndaj ATK-së

Kur AK e zgjedh një fitues, para nënshkrimit të kontratës një nga dokumentet që duhet dorëzuar është vërtetimi i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për të vërtetuar se një OE nuk ka borxhe ndaj ATK-së. Kjo kërkesë përveç se është në dosje të tenderit, kërkohet edhe sipas nenit 65.4.8 të LPP-së. Në dosje të tenderit theksi i kërkesës është që vërtetimi duhet të jetë me datë para hapjes së ofertave dhe kjo nënkupton që një OE në momentin që dorëzon tenderin nuk duhet të ketë borxhe ndaj ATK-së. Megjithatë, në dy raste OSHP nuk ka vendosur njëjtë për këtë çështje.

### Astraplan v. Ministria e Punëve të Brendshme, 130/17

Në OSHP u ankua Astraplan kundër vendimit të AK për dhënie të kontratës, me arsyen se OE fitues, Mercom Company kishte borxhe ndaj ATK-së. Eksperti shqyrtues, Visar Bibaj, rekomandoi që tenderi të kthehet në rivlerësim pasi OE fitues kishte dorëzuar vërtetim të ATK-së që ka marrëveshje për shlyerje të borxheve më këste, por vërtetimi e kishte datën pas hapjes së ofertave. Është e vërtetë që ky vërtetim kërkohet vetëm nga fituesi i cili zgjedhet pasi të hapen ofertat, por prapë çdo dokument në këtë rast duhet të datojë para

36 OSHP. Vendimi 210/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/210-18vend.pdf>

datës së hapjes së ofertave. Në këtë tender AK kishte kërkuar vërtetim që OE nuk është në vonesë të pagesës së tatimit për tremujorin e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë.

Paneli vendosi që tenderi të kthehet në rivlerësim<sup>37</sup> duke cituar nenin 65.4.8 të LPP-së në arsyetim të vendimit, i cili thotë:

“

**4. OPERATORI EKONOMIK NUK KA TË DREJTË QË TË MARRË PJESË NË NJË AKTIVITET TË PROKURIMIT OSE NË EKZEKUTIMIN E NDONJË KONTRATE PUBLIKE, NËSE OPERATORI I TILLË EKONOMIK**

“

**4.8. AKTUALISHT ËSHTË ME VONESË NË PAGIMIN E ÇFARËDO KONTRIBUTEVE PËR SIGURIM SOCIAL APO TATIM NË KOSOVË OSE NË VENDIN E THEMELIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK, PËRVEÇ KU NJË BORXH I TILLË ËSHTË VËRTETUAR TË JETË JO I RËNDËSISHËM NË KOSOVË.**

Paneli gjithashtu ceku që OE fitues ka dorëzuar marrëveshjen për shlyerje të borxheve ndaj ATK-së, por kjo marrëveshje është me datë pas hapjes së ofertave. Siç vërehet nga ky vendim OSHP bënë dy konstatime me rëndësi, e para që OE fitues nuk mund të dorëzojë marrëveshje për shlyerjen e borxheve ndaj ATK-së por vërtetim se nuk ka borxhe ndaj saj, dhe e dyta, se data e këtij vendimi duhet të jetë para hapjes së ofertave.

### **Olti Trasing & Alba Group v. Ministria e Punëve të Brendshme, 391/18**

OSHP mori një vendim jokonsistent krahasuar me vendimin 130/17 pasi ktheu në rivlerësim tenderin duke aprovuar ankesën e Olti Trasing, i cili ishte eliminuar për shkak që nuk kishte sjellë vërtetimin që nuk kishte borxhe ndaj ATK-së për tremujorin e fundit të periudhës para njoftimit për dhënie të kontratës<sup>38</sup>. AK në fakt e kishte shpallur si fitues konzorciumin Olti Trasing & Alba Group, me çka edhe e kishte ftuar për të nënshkruar kontratën. Anëtari i konzorciumit, Alba Group kishte sjellë vërtetimin e ATK-së, i cili kishte vërejtje që ky OE kishte borxhe. Sipas nenit 71.4 që flet për konzorciume, kërkesat e përshtatshmërisë ku bën pjesë edhe vërtetimi i ATK-së, aplikohen për të gjithë anëtarët e grupit. Pasi Alba Group e kishte vërtetimin që kishte borxhe dhe nuk kishte ndonjë marrëveshje për shlyerje të borxhit me këste, AK kishte vazhduar duke shpallë si fitues OE e dytë me çmimin më të ulët.

Në arsyetim të vendimit paneli tha se AK duhet të kërkojë sqarime sipas nenit 72 dhe mori parasysh që OE ankues ka çmim më të lirë. Ky vendim është jokonsistent me vendimin 130/17 pasi në atë vendim paneli kishte thënë që OE fitues nuk mund të sjellë marrëveshje për shlyerje të borxheve ndaj ATK me datë pas hapjes së ofertave. Marrëveshja për shlyerje të borxheve nënkupton që OE kishte borxhe ndaj ATK-së dhe nuk ka mundur të sjellë vërtetim që nuk ka borxhe e të jetë me datë para hapjes së ofertave. Në vendimin 391/18 paneli tha që të kërkohe sqarime, që në këtë rast nënkupton që anëtari i konzorciumit do të dorëzonte një marrëveshje për shlyerje të borxhit ndaj ATK-së i cili do të ishte me datë pas hapjes së ofertave. Paneli deklaroi gjithashtu që OE ankues është më i lirë se OE fitues si dhe AK duhet ta ketë parasysh qëllimin e prokurimit dhe të sigurohen që fondet publike do të shpenzohen në mënyrë më ekonomike. Për këtë tender oferta e Olti Trasing & Alba Group ishte më e lirë për 21,660.02 euro se oferta e OE fitues, Euroing. Por paneli në vendimin 130/17 nuk e kishte thënë që fondet publike duhet të shpenzohen në mënyrë më ekonomike, pasi në atë rast oferta e OE fitues, Mercom Company ishte për 57,742.8 euro më e lirë se oferta e OE ankues.

<sup>37</sup> OSHP. Vendimi 130/17. 2017  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/130-17vend.pdf>

<sup>38</sup> OSHP. Vendimi 391/18. 2018  
[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/391-18vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/391-18vendim_1.PDF)



Eksperti shqyrtues, Hasim Krasniqi, dha rekomandim që ank-esa të refuzohet pasi Alba Group kishte dështuar të sjellë vërtetimin që nuk kishte borxhe ndaj ATK-së. Për të mbështetur rekomandimin, eksperti ishte bazuar në nenin 65.4.8 të LPP-së dhe nenin 26.8 të Udhëzuesit.

Me këtë vendim të OSHP-së, problemi është se sipas nenit 65.4.8 të cilin paneli e kishte cituar në vendimin 130/17, një OE nuk ka të drejtë as të marrë pjesë në tender nëse ka borxhe ndaj ATK-së. AK në këtë rast veprimi edhe sipas Udhëzuesit i cili sipas nenit 26.8 në faqe 61-62 thotë që nëse një OE shpallet fitues dhe dështon të sjellë vërtetimet që kërkohen në kërkesat e përshtatshmërisë (ku bën pjesë vërtetimi i ATK-së), oferta e tij do të refuzohet, do të konfiskohet sigurimi i tenderit si dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim (futje në listë të zezë) sipas nenit 99.2 të LPP-së<sup>39</sup>. Në këtë rast, AK vetëm ka vazhduar me ofertuesin e dytë por nuk ka kërkuar procedurë për diskualifikim. Paneli në rastet kur një OE dështon të sjellë vërtetimin që nuk ka borxhe ndaj ATK-së duhet të vendosë gjithmonë kundër OE, pasi borxhi ndaj ATK-së nënkupton që një OE nuk është duke paguar me rregull tatimin dhe kjo është një shkelje serioze që e parasheh edhe LPP, i cili nuk lejon një OE as të ofertojë nëse ka borxhe.

Pas rivlerësimit, AK zgjodhi fitues përsëri OE e njëjtë, Euroing. Pas këtij vendimi përsëri në OSHP u ankua Olti Trasing & Alba Group. AK gjatë procedurës së rivlerësimit kërkoi sqarime nga Alba Group në mënyrë që të sjellë vërtetimin se nuk ka borxhe ndaj ATK-së, por që ky vërtetim të jetë me datë para 4 korrikut 2018. Kjo datë ishte pas hapjes së ofertës por para njoftimit për dhënie të kontratës. Eksperti shqyrtues tha që AK nuk mund të caktojë një datë fikse, por është dashur që të veprojë sipas kërkesës që OE fitues të dorëzojë vërtetimin e ATK-së para publikimit për dhënie të kontratës. Këtë kërkesë në fakt Alba Group kishte dështuar ta plotësonte pikërisht kur ishte zgjedhur fitues dhe ky dokument i është kërkuar para njoftimit për dhënie të kontratës. Alba Group dorëzoi vërtetimin që ka marrëveshje për shlyerje të borxhit me këste më 1 tetor 2018, të cilin e kishte nxjerrë më 31 gusht 2018. Mirëpo, duke cituar vendimin e kaluar si dhe duke pasur parasysh që OE ankues kishte ofertë më të ulët, eksperti rekomandoi që tenderi të kthehet në rivlerësim.

Duke u bazuar në sqarimet e ekspertit, paneli u arsyetua se oferta e OE ankues ishte më e lirë për 21,660.02 euro. Për më tepër, paneli tha që AK nuk mund të caktojë datë fikse për marrje të vërtetimit të ATK-së, dhe bazuar në këtë interpretim tha që AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së i cili thotë që një OE nuk mund të eliminohet për një kriter ose kërkesë që nuk është kërkuar në dosje të tenderit. Por pikërisht në dosje të tenderit është kërkuar që vërtetimi të jetë pa borxhe dhe ai duhet të dorëzohet para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës. Sipas nenit 26.8 të Udhëzuesit, OE i shpallur fitues ka afat pesë ditë që të sjellë dokumentet e kërkuara në kërkesat e përshtatshmërisë. Në këtë rast Alba Group e ka tejkaluar dukshëm afatin prej pesë ditësh, pasi u zgjodh fitues në fillim të muajit korrik 2018, ndërsa e dorëzoi vërtetimin e ATK-së me 1 tetor 2018. Duke u bazuar në këto arsyetime paneli përsëri ktheu tenderin në rivlerësim<sup>40</sup>.



Pas rivlerësimit AK anulon tenderin me arsyen:

*Nga Departamenti i Prokurimit nuk ka qenë e mundur të zbatohet vendimi për rivlerësim i OSHP-së nr. 578/18, sepse AME nuk ka formuar komisionin e Rivlerësimit të ofertave dhe për këtë është njoftuar OSHP-ja nga AK-MPB, prandaj bëhet anulimi i procedurës së prokurimit publik për këtë aktivitet të prokurimit.<sup>41</sup>*

Në dy vendimet më lartë paneli ka marrë vendim jokonsistent. Në vendimin 130/17 paneli me të drejtë bazohet në nenin 65.4.8 të LPP-së. Në këtë nen do të duhej të bazohet edhe në vendimin 391/18 pasi mosvonesa në pagesë të tatimit është kusht për pjesëmarrje në tender. Nëse një OE arrin të zgjedhet fitues me borxhe ndaj ATK-së atëherë kjo është shkelje e nenit 65.4.8 të LPP-së.

39 Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. 2017 <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/2018/04/rruopp13042018.pdf>

40 OSHP. Vendimi 578/18. 2018 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/578-18vend.pdf>

41 B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit. E-prokurimi. <http://bit.ly/2WBltog>

## Vendimet për nënvizim të katalogut

Disa AK, për produktet që kërkohen në paramasë, kërkojnë në dosje të tenderit që ofertuesi të nënvizojë në katalog produktin më të cilin oferton. Kjo kërkohet pasi disa kompani katalogjet i kanë voluminoze dhe AK dëshiron ta ketë të qartë se cili është produkti i ofruar. OSHP përmes dy vendimeve, ka krijuar jokonsistencë në vendimmarrje.

### ATM Engineering v. KEK, 78/18

Në tenderin “Furnizim me pjesë rezervë për analizat e matjeve ujë-avull” KEK kishte kërkuar që ofertuesi të nënvizojë në katalog artikujt që janë kërkuar në tender. Fitues ishte zgjedhur Inline Engineering, ndërsa kundër këtij vendimi në OSHP u ankua ATM Engineering me pretendimin që fituesi nuk i ka të nënvizuara produktet në katalog, që ishte edhe kërkesë në dosje të tenderit. Eksperti shqyrtues Visar Basha rekomandoi që të refuzohet ankesa me arsyetimin se nënvizimi i katalogëve nuk mund të përdoret si kriter kualifikues. Me rëndësi, sipas tij, është që OE fitues e ka dorëzuar katalogun. Paneli vërtetoi dhënien e kontratës për Inline Engineering<sup>42</sup> me arsyetimin e njëjtë me atë të ekspertit përveç pjesës së shtuar se “nënvizimi i katalogut nuk ka qenë kriter”.

### Kodra AK v. KEK, 158/19

Në një vendim tjetër për të njëjtin pretendim, paneli e ktheu tenderin në rivlerësim<sup>43</sup>. Kodra AK ishte ankuar me pretendimin që OE i rekomanduar Inline Engineering nuk i ka të nënvizuar në katalog produktet e kërkuara. Paneli në arsyetimin citoi kërkesën e dosjes së tenderit për nënvizim të produkteve në katalog. Pasi të dy tenderët janë të KEK-ut, kërkesa ishte e njëjtë në të dy rastet.

Të dy këto vendime janë kundërthënëse mes vete. Nëse paneli për një kërkesë që është në dosje të tenderit thotë që “edhe po të jetë kërkesë nuk mund të përdoret si kriter kualifikues” hap rrugë për ankesa të shumta nga OE.

42 OSHP. Vendimi 78/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/78-18vendim.pdf>

43 OSHP. Vendimi 158/19. 2019

<http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/158-19vend.pdf>

44 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. Neni 18.3. Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik. 2018

<https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/2018/04/rroopp13042018.pdf>

45 OSHP. Vendimi 618/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/618-18vend.pdf>

## Vendimet për numra pas presjes dhjetore

Sipas Udhëzuesit<sup>44</sup>, çdo çmim lejohet të shënohet deri në dy numra pas presjes dhjetore. Nëse OE shënon më shumë se dy numra, atëherë oferta e tij cilësohet e papërgjegjshme dhe kjo është bërë për të parandaluar çmimet manipulative. Përrjashtim është kur AK e vendosë në dosje të tenderit që lejohet të ofrohet me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore. Mirëpo, në informatat e përgjithshme në dosje të tenderit, neni 20.1, thotë që nëse ofertuesi shënon më shumë se dy numra pas presjes dhjetore, vetëm dy numrat e parë do të merren si bazë për llogaritje. Pra vërehet që është një mospërputhje në mes të dosjes së tenderit dhe Udhëzuesit. Si rezultat janë dy vendime nga OSHP që kanë jokonsistencë mes vete.

### Laguna v. KEK, 618/18

Kompania Laguna ishte ankuar në OSHP për shkak që AK e kishte eliminuar sepse çmimet e dhëna i kishte me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore. Eksperti shqyrtues Visar Basha rekomandoi që të refuzohet ankesa pasi neni 18.3 i Udhëzuesit thotë që oferta është e papërgjegjshme nëse ka më shumë se dy numra pas presjes dhjetore. Paneli duke u mbështetur në rekomandimin e ekspertit, refuzoi ankesën dhe konfiskoi tarifën e ankesës<sup>45</sup>.

### Commando v. Komuna e Prizrenit, 98/19

Në tenderin për sigurim fizik të objekteve, OE Commando ishte shpallur i papërgjegjshëm me një nga arsyet sepse kishte ndryshuar listën e punëtorëve pas kërkesës për sqarim nga AK. Por një nga pretendimet ankimore të tij ishte se OE i rekomanduar, Rosa Security kishte shënuar çmimin për orë punë me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore. Eksperti shqyrtues Hasim Krasniqi, për këtë pretendim citoi nenin 20.1 të dosjes së tenderit në pjesën e informatave të përgjithshme. Sipas këtij neni, çdo numër i dhënë pas numrit të dytë pas presjes dhjetore nuk do të merret parasysh në llogaritje. Në arsyetimin të vendimit paneli për këtë pikë citoi nenin:



5.3 të Fletës së të Dhënave të Tenderit (FDT)<sup>46</sup>. Sipas panelit ky nen përmbante këtë kërkesë:

*“Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshijnë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera. Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presjes dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës.”*



Neni 5.3 i FDT<sup>47</sup> përmban tekstin më poshtë e jo atë që ka dhënë paneli në arsyetim të vendimit.

*“Kushtet e dërgesës: DDP (detyrat e dërguara të paguara)”*

Paneli vetëm konstatoi që çmimi i Rosa Security është me tre numra pas presjes dhjetore, pa dhënë arsyetim se a ishte pretendimi i Commandos i bazuar apo jo. Paneli vendosi që të vërtetohet vendimi për dhënie të kontratës<sup>48</sup>. Vendimi ishte i drejtë pasi OE ankues ishte i papërgjegjshëm për shkak se kishte ndryshuar listën e punëtorëve. Mirëpo për pikën ankimore për numra pas presjes dhjetore, paneli do të duhej ta kishte parasysh nenin 18.3 të Udhëzuesit. Siç ceket më poshtë, OSHP për pretendim të njëjtë në një vendim tjetër refuzoi ankesën.

### Construction Group v. Ministria e Punëve të Brendshme, 526/18

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) kishte eliminuar kompaninë Construction Group me arsyen se çmimet në

ofertë kishin nga tre numra pas presjes dhjetore, duke u bazuar në nenin 18.3 të Udhëzuesit. Pikërisht për këtë pikë Construction Group u ankua në OSHP me pretendimin se neni 20.1 i dosjes së tenderit lejon më shumë se tre numra pas presjes dhjetore, por vetëm dy të parët merren parasysh për llogaritje. Eksperti shqyrtues, Visar Bibaj rekomandoi që ankesa të refuzohet pikërisht pasi çmimi i dhënë nga OE ankues binte ndesh me nenin 18.3 të Udhëzuesit. Njëjtë mendoi dhe paneli që vërtetoi vendimin për dhënie të kontratës<sup>49</sup>.

OSHP, për pretendimet për numra pas presjes dhjetore duhet të vendosë duke u bazuar në nenin 18.3 të Udhëzuesit, pasi ai është dokument më rëndësi më të madhe se sa informatat e përgjithshme të dosjes së tenderit. Edhe pse në vendimin 98/19 paneli në përgjithësi ka vendosur drejtë, arsyetimi është jokonsistent me dy vendimet tjera të përmendura më lartë. Shqetësues është fakti i citimit që paneli i ka bërë neni 5.3 të FDT, teksti i të cilit në dosje të tenderit ishte komplet ndryshe. Kjo e zvogëlon në masë të madhe besueshmërinë në vendimet e OSHP-së.

## Vendimet për deklaratën mbi specifikat teknike



Në dosjet standarde të tenderit të miratuara nga KRPP, në FDT është pika 3.1 e cila thotë:

*“Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit”*

Kjo kërkesë nënkupton që ofertuesi duhet të nënshkruajë një deklaratë përmes së cilës konfirmon se specifikat teknike për produktin që ka ofruar janë në përputhje me ato të kërkuara në dosje të tenderit. Pasi kjo kërkesë është në çdo dosje, paneli në disa vendime ka thënë që kërkesa është

46 Fleta e të Dhënave të Tenderit është pjesë e dosjes së tenderit, ku autoriteti kontraktues shënon informatat dhe kërkesat për operatorët ekonomik.

47 Dosja e Tenderit "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prizrenit". E-Prokurimi. <http://bit.ly/2XIMmJS>

48 OSHP. Vendimi 98/19. 2019 <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/97-98-19vend.pdf>

49 OSHP. Vendimi 526/18. 2018 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/526-18vend.pdf>

vetëm “shabllon” dhe duhet të ceket në mënyrë decisive. Mirëpo, çka nënkuptohet me “mënyrë decisive”, asnjëherë nuk është shpjeguar nga paneli. Përderisa është kërkesë në dosje të tenderit dhe ofertuesi më dorëzimin e tenderit i pranon të gjitha kushtet e tenderit, atëherë edhe pika 3.1 e FDT-së është kërkesë që duhet plotësuar. Mirëpo paneli në një numër të vendimeve tjera ka vendosur ndryshe.

### Virtuo v. Policia e Kosovës, 39/18

Për tenderin “Furnizim me Licensa për Software - Backup” OSHP kishte nxjerrë katër vendime për ankesat e Virtuo. Në të gjitha vendimet tenderi ishte kthyer në rivlerësim. Në katër vlerësime AK e kishte eliminuar Virtuo për arsye të licencave të softverit, mirëpo herën e pestë për shkak se nuk kishte dorëzuar deklaratën për specifika teknike. Prendim i vetëm ankimor në ankesën e Virtuo ishte pikërisht eliminimi për mungesë të kësaj deklarate. Eksperti teknik, Zenel Hisenaj rekomandoi që ankesa të aprovohet dhe tenderi të kthehet në rivlerësim. Arsyetimi tij ishte se kërkesa për deklaratë për specifikim teknik është “shabllon” në dosje të tenderit. Për të përforcuar arsyetimin e tij eksperti theksoi që kërkesat e AK në dosje të tenderit janë bërë më ngjyrë më të trashë (bold), ndërsa neni 3.1 i FDT nuk ishte me bold.

Në arsyetim të vendimit paneli u bazua në fjalët e ekspertit teknik, që kërkesa është shabllon i çdo dosjeje të tenderit e gjithashtu AK kërkesat i ka theksuar me ngjyrë bold. Vendimi ishte që përsëri të bëhej rivlerësim<sup>50</sup>.

### Sinjal v. Komuna e Lipjanit, 730/18

Në një vendim tjetër OSHP vendosi ndryshe për ankesat në lidhje me nenin 3.1 të FDT-së. Për tenderin “Furnizimi dhe montimi i pajisjeve sinjalizuese në qytetin e Lipjanit” OSHP ka nxjerrë katër vendime. Në dy vendime për deklaratën për specifikim teknik paneli ka dhënë arsyetim kundërtë. Së pari në vendimin 458/18<sup>51</sup>, ku ankues ishte Eing Com, paneli u arsyetua se kërkesa për deklaratë për specifikim teknik nuk ka qenë pjesë e dosjes së tenderit. Edhe pse sipas panelit

deklarata është në FDT, nuk është pjesë e dosjes së tenderit. Propë mbetet e paqartë se çka nënkuptohet sipas panelit kur një kërkesë ekziston në një dokument (dosja e tenderit në këtë rast), por nuk është kërkuar decidivisht. Edhe eksperti shqyrtues Qazim Hoxha rekomandoi njëjtë me vendimin e panelit, pra të bëhet rivlerësimi i tenderit.

Pas rivlerësimit, Eing Com u ankua sërish, me një nga pikat ankimore pikërisht për deklaratën për specifikim teknik. Paneli përsëri u arsyetua që deklarata nuk ka qenë kërkesë në dosje të tenderit dhe tenderi për herë të dytë u kthye në rivlerësim<sup>52</sup>. Në këtë rast ekspert shqyrtues ishte Burim Guri i cili njëjtë si Qazim Hoxha tha që edhe pse deklarata në FDT ekziston si pozicion është e qartë se nuk është kërkuar në dosje të tenderit.

Pas vlerësimit të tretë, AK fitues zgjodhi Eing Com. Kundër këtij vendimi u ankua kompania Sinjal, e cila pretendoi se Eing Com nuk e ka deklaratën për specifikim teknik. Paneli kësaj radhe për këtë pretendim ra në kundërshtim me arsyetimet e mëparshme.



Paneli konstatoi që Eing Com-it i mungon deklarata<sup>53</sup>:

*“Pretendimi i parë i OE është që OE i propozuar për kontratë nuk ka paraqitur deklaratën mbi specifikimet teknike. Paneli shqyrtues konstaton se është i qëndrueshëm ky pretendim.”*

Këtë herë OSHP kishte angazhuar dy ekspertë, ekspertin shqyrtues Visar Bibaj dhe atë teknik, Defrim Bojaj. Eksperti teknik tha se OE i rekomanduar e ka deklaratën, por eksperti e kishte ngatërruar atë me deklaratat mbi themelimin e konzorciumit. Ekspertët rekomanduan refuzim të ankesës, ndërsa paneli vendosi përsëri për rivlerësim.

Pas vlerësimit të katërt, përsëri u ankua Sinjali, ndërsa OE i rekomanduar ishte Eing Com. Ekspertët ishin të njëjtit si

50 OSHP. Vendimi 39/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/39-18vendim.pdf>  
 51 OSHP. Vendimi 458/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/458-18vend.pdf>  
 52 OSHP. Vendimi 589/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/589-18vend.pdf>  
 53 OSHP. Vendimi 730/18. 2019  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/730-18vend.pdf>

në vendimin e tretë. Këtë herë ekspertët thanë se gjendet deklarata mbi specifikimin teknik në ofertën e Eing Com, por pasi paneli në vendimin 730/18 kishte thënë që deklarata nuk është dorëzuar, atëherë ekspertët rekomanduan anulim të tenderit pasi nuk kishte oferta të përgjegjshme. Paneli vendosi për vërtetim të dhënies së kontratës pasi deklarata ishte gjetur në ofertën e OE të rekomanduar<sup>54</sup>.

Arsyetimi i panelit në dy vendime është kundërthënës mes vete. Për të pasur konsistencë paneli duhet të vendosë se a është deklarata mbi specifikimin teknik vetëm shabllon apo është pjesë e kërkesave të dosjes së tenderit. Për më tepër arsyetimi i panelit se kërkesat AK i dallon me ngjyrë bold mund të shpie në situata më të rrezikshme dhe ankesa të reja. Në shumicën e dosjeve të tenderit AK-të kërkesat i dallojnë me ngjyra tjera ose me bold. Mirëpo janë edhe disa kërkesa që janë pjesë standarde të dosjeve të tenderit siç janë neni 3.1 për deklaratë mbi specifikat teknike, neni 5.3 për kushtet e dërgesës, neni 11.1 për deklaratat për konzorcium, etj. Po të merret parasysh arsyetimi i panelit se kërkesa në nenin 3.1 është vetëm shabllon atëherë edhe ajo në 11.1 do të duhej të ishte njëjtë pasi është pjesë e dosjeve standarde të aprovuara nga KRPP. Është një arsye pse deklarata për specifikim teknik kërkohet në dosjet e tenderit për punë e furnizime, ndërsa nuk kërkohet në atë për shërbime, pasi tenderët për shërbime nuk kanë specifika teknike të produkteve.

## Vendimet jonkonsistente për tender të njëjtë

Për disa tenderë në OSHP ka vazhdimisht ankesa, aq sa ka raste kur tenderi kalon më se dy vite në procedura ankimore dhe rivlerësime. Për shkak të jokonsistencës ka raste kur paneli për një pretendim të njëjtë ankimor, për tender të njëjtë ka vendosur ndryshe për një ankues e ndryshe për një tjetër. Prandaj në rastet kur kërkesa është e pamatshme, është më mirë që tenderi të anulohet dhe të përmirësohen gabimet. OSHP ka shkelur edhe urdhëresat e veta, së pari duke urdhëruar rivlerësim e në ankesën tjetër për të njëjtin tender ka vërtetuar anulimin e tenderit nga AK. Pasojat e jokonsistencës vërehen në humbje të kohës e kjo shkakton pastaj komplikime tjera si në buxhet ose humbje të interesit

nga AK që të vazhdojë më tutje aktivitetin. Një vendim që paneli ka mund ta marrë që në ankesën e parë, si pasojë e interpretimeve të panelit shtyhet edhe për disa muaj edhe ankesa të radhës.

### Vendimet për tenderin “Furnizim me Citostatik nga Lista Esenciale lot 6,14”

MSH publikoi tenderin për furnizim me citostatik nga Lista Esenciale e barnave më 17 korrik 2017. Për llotin 6 (produkti Cistplatin) dhe 14 (produkti Fluouracil) të këtij tenderi MSH anuloi tenderin për shkak që oferta e OE Liri Med kishte tejkualuar buxhetin e parashikuar për këto dy lloje. Në dosje të tenderit AK kishte dhënë vlerën e parashikuar për secilin llot. Kundër vendimit për anulim të tenderit në OSHP u ankua Liri Med. Eksperti shqyrtues Xhevdet Bushi, edhe pse e pati parasysh që oferta për llot 6 tejkualonte buxhetin për 11.5% dhe për llot 14 për 267%, tha që pasi MSH nuk ka dhënë kontratë për të gjitha llotet, ka akoma mjete në dispozicion. Më tutje ai shtoi se pasi kjo është kontratë kornizë për 24 muaj, buxheti mund të shtohet nga vitet e ardhshme dhe rekomandoi që tenderi të kthehet në rivlerësim.

Një arsyetim tjetër i ekspertit ishte se pas kërkesës për rishqyrtim, MSH e kishte cilësuar si të përgjegjshme ofertën e Liri Med por tenderin e kishte anuluar për tejkualim të buxhetit. AK e ka përmirësuar gabimin e vet në këtë rast pasi nëse një ofertë tejkalon buxhetin nuk mund të cilësohet e papërgjegjshme, por cilësohet e pasuksesshme. Më tej eksperti shtoi që Liri Med ka prezentuar faturat e disa barnatoreve ku thotë që çmimi i ofruar është më i ulët se çmimi i tregut. Këtë e pranoi edhe MSH gjatë seancës dhe shtoi se Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA), në këtë rast sekretari i MSH ka thënë të ju përmbahen buxhetit të planifikuar. Në mënyrë që të shtohet buxheti mbi vlerën e parashikuar ai duhet të aprovohet nga ZKA, që në këtë rast nuk është aprovuar.

Interpretimi i ekspertit për tejkualim buxheti është i gabuar pasi është e drejtë e AK të pranojë apo jo një ofertë që tejkalon buxhetin e paraparë sipas nenit 62 të LPP-së. Një AK mund edhe të keqplanifikojë buxhetin, duke planifikuar çmimin e një produkti më të ulët se sa në treg por kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë që AK duhet të shtojë buxhetin nëse një OE ofron mbi vlerën e parashikuar. Interpretim tjetër i gabuar është ai për llotet dhe kontratën kornizë.

54 OSHP. Vendimi 94/19. 2019  
<http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/94-19vendim.pdf>

Ndarja e vlerës së parashikuar për secilin llot nënkupton që mjetet e destinuar për një llot nuk mund të përdoren për një llot tjetër. Mendimi i ekspertit që mund të paguhet produkti me mjete të lloteve tjera dhe viteve tjera është gabim pasi AK e vendos vlerën e parashikuar për të blerë një produkt me një çmim të caktuar që është edhe maksimumi që dëshiron të paguaj.



Për ta ilustruar më thjeshtë e marrim një shembull:

*AK dëshiron të blejë pesë pako me aspirin me vlerë të parashikuar 10 euro. Kjo nënkupton që maksimumi që AK mund të paguajë për një pako është dy euro. Nëse një OE jep ofertë më të lartë, shembull 15 euro, i bjen që një pako aspirin OE po e ofron për tri euro. Sipas mendimit të ekspertit dhe panelit, pasi është kontratë kornizë AK mund të shtojë mjete nga buxheti i vitit pasues. Por problemi këtu qëndron që AK dëshiron t'i blejë pesë pako me aspirin për 10 euro, e jo për 15 euro.*

Gjatë seancës kryetari i panelit, Blerim Dina pyeti OE se a janë të pajtimit të lidhin kontratë me aq sa ka mjete AK, mirëpo këtë pyetje nuk ja bëri edhe përfaqësuesit të AK-së. Liri Med u përgjigj që është e pajtimit të lidh kontratë me aq sa ka mjete në dispozicion. Paneli vendosi që ta kthejë tenderin në rivlerësim me arsyetimin se AK ka parashikuar vlerë jo reale të tregut<sup>55</sup>. Më tej, paneli shtoi se duke marrë parasysh që OE u pajtua që të nënshkruajë kontratë për aq sa ka mjete, atëherë AK është e obliguar që ta bëjë një gjë të tillë. Paneli gjithashtu pati parasysh rëndësinë e këtyre produkteve mjekësore dhe shëndetin e qytetarëve që të mos mbesin për një kohë të gjatë pa këto furnizime. Nga 1,200 vendime që D+ ka analizuar që nga 1 janari 2017, ky është i vetmi vendim ku OSHP obligon një AK të nënshkruajë kontratë.

NGA

**1,200**

VENDIME QË

**D+**

KA ANALIZUAR QË NGA 1 janari 2017  
KY ËSHTË I VETMI VENDIM KU

**OSHP**

OBLIGON NJË

**AK**

TË NËNSHKRUAJË KONTRATË.

Pas rivlerësimit, AK përsëri anuloi tenderin me arsyetimin e njëjtë, tejkalim i buxhetit, duke shtyrë Liri Med që të ankohej përsëri. Paneli përveçse aprovoi ankesën, këtë herë edhe urdhëroi AK që të zbatojë vendimin e kaluar<sup>56</sup>. Paneli e cilësoi këtë si rast të gjykuar duke cituar arsyetimet në vendimin paraprak. Të njëjtën gjë e tha edhe eksperti shqyrtues Xhevdet Bushi, duke rekomanduar përsëri rivlerësim të tenderit.

55 OSHP. Vendimi 24/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/24-18vendim.pdf>

56 OSHP. Vendimi 243/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/243-18urdherese.pdf>

Pasi paneli ktheu në rivlerësim tenderin për herë të dytë, AK gjatë periudhës së rivlerësimit kishte shpallur tender tjetër për furnizim me citostatik nga Lista Esenciale, duke futur edhe produktin Cistplatin. Përderisa në tenderin e parë ky produkt ishte në llotin 6, tani AK e kishte vendosur në llotin 11. Këtë e kishte vërejtur Liri Med i cili u ankua në OSHP kundër njoftimit për kontratë. Ankesa e tij ishte për shkelje të nenit 7 të LPP i cili flet për Barazi në trajtim/Jo diskriminim. Eksperti shqyrtues, Basri Fazliu rekomandoi që ankesa të aprovet dhe tenderi të anulohet me arsyen që tenderi për këtë produkt është ende në OSHP dhe ende nuk ka ndonjë vendim (eksperti e kishte fjalën për ankesën 243/18). Eksperti në rekomandimin e tij nuk citoi asnjë nen të LPP-së ose Udhëzuesit ku një AK nuk i lejohet që të hapë tender të ri nëse tenderi i parë është në procedurë në OSHP. Gjatë seancës AK deklaroi që tenderin e parë e kanë anuluar për shkak të tejkalimit të buxhetit dhe kanë shpallur tender të ri për shkak të urgjencës pasi për produktin Cistplatin nuk kishin furnizim që nga 6 shkurti 2017.

Paneli vendosi që tenderi të anulohet pasi produkti Cistplatin që ishte i përfshirë në tenderin e parë, OSHP ka lëshuar urdhëresë për moszbatim të vendimit 24/18<sup>57</sup>. Paneli në vendim konstatoi se nuk mund të zhvillohen dy procedura të prokurimit për furnizime të njëjta. Problemi më këtë konstatim është se as LPP e as Udhëzuesi nuk e ndalon një AK që të zhvillojë dy procedura prokurimi për të njëjtat produkte njëkohësisht.

Pas urdhëresës 243/18, AK përsëri anuloi tenderin e parë me arsyen e njëjtë, tejkalim buxheti. Eksperti Xhevdet Bushi përsëri rekomandoi rivlerësim. Eksperti me të drejtë tani tha që AK nuk ka respektuar dy vendimet paraprake, ku në vendimin e parë OSHP e kishte detyruar AK që të nënshkruajë kontratën për aq sa ka mjete.

Duke rënë në kundërshtim me vendimin e parë dhe urdhëresën, paneli vendosi që të vërtetojë anulimin e tenderit<sup>58</sup>. Paneli u bazua në arsyetimin e MSH që e kishte dhënë në të tri seancat, që oferta e Liri Med për llot 6 kishte tejkalim të buxhetit për 11.5% dhe për llot 14 tejkalim për 270%. Paneli tha që anulimi është bërë në bazë të nenit 62 i cili thotë që AK mundet të anulohet tenderin nëse ka tejkalim buxheti. Paneli

gjithashtu pati parasysht që AK ka bërë hulumtim të tregut në rajon dhe kanë vërtetuar që çmimet e Liri Med janë më të larta se në rajon. Së pari me këtë hulumtim nuk është konstatuar se ato janë më të larta se çmimi i tregut në Kosovë, dhe së dyti nuk është konstatuar se ato janë më të larta se vlera e parashikuar. Në vendim paneli gjithashtu thotë që është marrë parasysht edhe interesi publik që të mos dëmtohet buxheti, përderisa në urdhëresën 243/18 kishte thënë që shëndeti i qytetarëve është interes publik.

Për të mos humbur kohë, e që për këtë tender është rreth shtatë muaj, OSHP ka mundur që në vendimin e parë të vërtetojë anulimin e tenderit për shkak të tejkalimit të buxhetit.

57 OSHP. Vendimi 287/18. 2018.

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/287-18vend.pdf>

58 OSHP. Vendimi 479/18. 2018.

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/479-18vendim.pdf>

## VENDIMET PËR LISTËN E ZEZË

AK kur kanë dyshime që një OE ka paraqitur të dhëna të rreme ose ka falsifikuar ndonjë dokument, bëjnë kërkesë në OSHP për ta diskualifikuar një OE nga pjesëmarrja në aktivitetet të prokurimit për një periudhë të caktuar. Vendimet për diskualifikim, OSHP i kategorizon si vendime për listë të zezë. Në listë të zezë një OE mund të futet për maksimum 12 muaj sipas nenit 99.2 të LPP-së.

OSHP për periudhën qershor 2018 – maj 2019 ka marrë 20 vendime për listën e zezë. Përveç një kërkesë për futje në listë të zezë e cila është aprovuar, të tjerat janë refuzuar. Që nga 1 janari 2017, OSHP ka marrë 41 vendime për listë të zezë, ku vetëm shtatë prej tyre janë aprovuar.

Mirëpo, edhe përkundër këtyre vendimeve të OSHP-së, lista e zezë nuk është që ka pasur ndonjë efekt, pasi njëri nga OE të diskualifikuar, Pastor Kosova, ka aplikuar dhe ka fituar në një tender edhe pasi është diskualifikuar. Në vendimin 1135/17 të datës 14 mars 2018 OSHP e kishte diskualifikuar për gjashtë muaj Pastor Kosovën për shkak se kishte falsifikuar një autorizim<sup>59</sup>. Në bazë të vendimit, Pastor Kosova nuk do të kishte të drejtë të merrte pjesë në aktivitetet të prokurimit për gjashtë muajt e ardhshëm. Por, kompania në fjalë kishte ofertuar dhe fituar në një tender i cili ishte shpallur pas datës 14 mars 2018. Gjykata Themelore në Gjakovë kishte publikuar njoftimin për vendimin e AK më 1 qershor 2018 ku kontratën ja kishte dhënë Pastor Kosovës me çmim 1,054.92 euro<sup>60</sup>.

Një vit më vonë në mars 2019 OSHP aprovoi kërkesën e Komunës së Prishtinës për futje në listë të zezë të kompanisë

Viva Print. Kjo kompani kishte falsifikuar vërtetimin e ATK-së duke shënuar që nuk ka borxhe. Paneli gjatë seancës verifikoi përmes uebfaqes së ATK-së se kompania kishte borxhe. Për këtë mashtrim paneli vendosi që Viva Print të diskualifikohej për periudhën nga 10 prill – 10 tetor 2019<sup>61</sup>.

Si në rastin e Pastor Kosova, diskualifikimi nuk e ka penguar Viva Print që të fitojë tender edhe pasi është diskualifikuar nga pjesëmarrja në tender publik. Viva Print ka nënshkruar kontratën me komunën e Prizrenit për tenderin “Auditimi inspektimi dhe analiza e riorganizimit të rrugëve në qytetin e Prizrenit” me çmim 117,500 euro pikërisht në ditën kur ka hyrë në fuqi diskualifikimi, më 10 prill 2019<sup>62</sup>.

Kjo është një e metë e sistemit të prokurimit në të cilën nuk merren masat për t’iu pamundësuar këtyre operatorëve që të ofertojnë duke i suspenduar nga platforma e e-Prokurimit. Kjo është lehtë e arritshme pasi tani të gjitha ofertat duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike.

Nga 19 kërkesat për diskualifikim që OSHP i kishte refuzuar, arsyetimet e panelit ishin pothuajse të njëjta, “AK nuk ka dëshmi që OE ka ofruar dëshmi të rreme ose dokument të falsifikuar sipas nenit 99.2 të LPP-së”. Interpretimi se çka konsideron paneli dëshmi të rreme ose falsifikim është edhe baza pse këto kërkesa janë refuzuar.

Një nga kërkesat për diskualifikim e kishte bërë Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) kundër OE Commando. AQP e kishte shpallë fitues Commandon dhe para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës kishte kërkuar që Commando të sjellë,

59 OSHP. Vendimi 1135/17. 2018.

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/1135-17vend.pdf>

60 Gjykata Themelore e Gjakovës. Njoftim për vendimin e AK. 2018.

[https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN\\_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=159145](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=159145)

61 OSHP. Vendimi 178/19. 2019

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/178-19lz.pdf>

62 Kontrata 622-19-003-221 në mes Intrast & Viva Print dhe komunës së Prizrenit. E-prokurimi

<http://bit.ly/2KvMJy2>



ndër të tjera, edhe vërtetimin e ATK-së që nuk ka borxhe. AQP e kishte pritur për disa ditë, ndërsa Commando në fund të afatit kohor deklaroi se kishte borxhe ndaj ATK-së. Paneli vendosi që kërkesa të refuzohet me arsyen se Commando nuk ka dhënë të dhëna të rreme ose dokument të falsifikuar<sup>63</sup>.



Një OE gjatë përgatitjes së ofertës së tij, në dosje të tenderit nënshkruan deklaratën nën betim e cila thotë:

*“Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.”*

Neni 65.4.8 i LPP-së flet pikërisht për vërtetimin e ATK-së, e që siç është përmendur më lartë, OE nuk ka të drejtë as të ofertojë nëse ka borxhe ndaj ATK-së. Pasi vërtetimi i ATK-së kërkohet për tremujorin e fundit para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, Commando nuk ka mundur që borxhin ta krijojë gjatë periudhës në mes shpalljes së tenderit dhe përzgjedhjes së fituesit pasi kjo periudhë në këtë tender ka zgjatur rreth një muaj. Pra, Commando e ka ditur se ka borxhe ndaj ATK-së, ka deklaruar përmes deklaratës nën betim që i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë sipas nenit 65, e kjo mund të interpretohet se ka paraqitur të dhëna të rreme madje duke e nënshkruar edhe deklaratën nën betim, gjë e cila do të shtonte përgjegjësinë e OE. Sipas këtij interpretimi Commando do të duhej të diskualifikohej.

Po të kishte një mekanizëm të ndarjes së informatave në mes të ATK-së dhe KRPP-së, në fakt Commando as nuk do të duhej të lejohej të ofertonte pasi neni 65.4.8 në këtë rast thotë që një OE nuk lejohet të ofertojë nëse është me vonesë në pagesën e tatimeve.

Një rast tjetër që ka të bëjë për vërtetimin nga ATK, është vendimi për kërkesën për futje në listë të zezë të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) kundër kompanisë Astraplan. Këtë kërkesë OSHP e refuzoi përsëri me të njëjtin arsyetim, që MFSK nuk ka dëshmi që Astraplan ka paraqitur të dhëna të rreme ose falsifikim të dokumentit<sup>64</sup>. AK e kishte zgjedhur fitues Astraplan edhe pse ky i fundit nuk kishte dorëzuar vërtetimin nga ATK, së pari me arsyen që ka qenë jashtë Kosovës e pastaj me arsyen që kur është futur në sistem të ATK-së për të nxjerrë vërtetimin është habitur kur e ka parë që ka borxhe. Një deklaram i çuditshëm i ekspertit është kur thotë që AK ka masa tjera që mund të marrë ndaj Astraplan. Masa e vetme ishte konfiskimi i sigurisë së tenderit. Edhe për këtë kërkesë paneli do të mund të vendoste sipas interpretimit që OE nuk ka ofruar sipas kushteve që i ka pranuar në deklaratën në betim.

Një vendim tjetër ku OSHP refuzoi kërkesën për diskualifikim është edhe kërkesa e Komunës së Vushtrrisë kundër kompanisë Commando. Komuna kishte kërkuar diskualifikim pasi Commando e cila kishte fituar kontratën, nuk kishte paguar për një pjesë të punëtorëve kontributin pensional prej 5% ashtu siç parashihet me Ligjin e Punës. Këtë konstatim të komunës e kishte mbështetur edhe eksperti Basri Fazliu. Në dosje të tenderit komuna shprehimisht e kishte cekur se pagës neto duhet t'i shtohet tatimi, kontributi pensional i punëtorit dhe i punëdhënësit. Paneli përsëri duke përdorur arsyetimin e njëjtë si në vendimin për kërkesën e AQP-së refuzoi kërkesën për diskualifikim<sup>65</sup>. Paneli shtoi gjithashtu që AK në rast se ka mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e kontratës ajo të zgjidhet duke u bazuar në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve<sup>66</sup>.

63 OSHP. Vendimi 723/18. 2018.

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/723-18lz.PDF>

64 OSHP. Vendimi 737/18.

2018 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/737-18lz.PDF>

65 OSHP. Vendimi 1078/18. 2018.

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/1078-18%20end%20end%20disk.pdf>

66 Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2012.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2828>

Për këtë çështje paneli ka mundur që ta interpretojë Formularin për dorëzimin e tenderit i cili parasheh:



## 2. NE OFROJMË TË DORËZIJMË, NË PAJTIM ME KUSHTET E DOSJES SË TENDERIT DHE AFATET KOHORE TË PARAQITURA, PA REZERVË APO KUFIZIM.

Sipas këtij neni, Commando, përderisa ka dorëzuar tenderin është pajtuar me kushtet e dosjes së tenderit, e një nga kushtet pra ka qenë që të paguajë kontributin pensional të punëdhënësit. Paneli do të mund ta diskualifikonte, i cili është një vendim administrativ, ndërsa komuna do të mund të ia konfiskonte sigurinë e ekzekutimit dhe dërgonte këtë lëndë në gjykatë për shkelje të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës<sup>67</sup>.

Një një rast tjetër, komuna e Kaçanikut kërkoi që kompania Blendi të diskualifikohej pasi lloptopët që kishtë dërguar nuk përputheshin me specifikat e kërkuara në dosje të tenderit. Edhe këtë kërkesë OSHP e refuzoi me arsyetimin tashmë të njëjtë që "OE nuk ka paraqitur të dhëna të rreme ose falsifikim"<sup>68</sup>. Edhe në këtë rast paneli do të mund të merrte për bazë nenin 2 të formularit për dorëzim të tenderit, siç është cekur më lartë. Komuna kishte kërkuar të blinte 140 lloptopë, ndër të tjerash që procesori i lloptopëve të jetë Intel Core i3 7020U. Komisioni i pranimit të lloptopëve konstatoi se Blendi kishte sjellë lloptop me procesor Intel Celeron N3350. Nga faqja zyrtare e prodhuesit Intel, çmimet e rekomanduar për këta dy procesorë janë 281 dhe 107 dollarë<sup>69</sup>. Pra vetëm për procesorin dallimi në çmim është 174 dollarë, apo rreth 155 euro, ndërsa për 140 lloptopë dallimi është 21,700 euro. Pa paragjykuar që edhe në pjesë të tjera të lloptopit ka mundur të ketë ndryshime, Blendi ka tentuar ta mashtrtojë komunën për së paku 21,700 euro. Komisioni i pranimit në procesverbal kishte shënuar vërejtje se edhe përfaqësuesi i Blendit ishte

pajtuar me konstatimin se lloptopët nuk janë sipas kërkesës. Komuna kishte konfiskuar sigurinë e ekzekutimit në vlerë 10% të vlerës së kontratës, që në këtë rast ishte 5,042 euro.

Paneli në arsyetim të vendimit u shpreh se AK nuk ka dëshmi se OE ka mashtruar apo ka falsifikuar ndonjë dokument apo dëshmi. Mirëpo AK në këtë rast kishte ofruar dëshmi, procesverbalin nga pranimi i mallit i përbërë nga një komision prej tre anëtarëve dhe gjithashtu konstatuar se edhe OE është pajtuar me të gjeturat e komisionit.

Interpretimi që paneli po i bën nenit 99.2 e bën shumë të vështirë diskualifikimin e kompanive, e sidomos të atyre që mashtrrojnë. Pa dashur që mashtrimet të kategorizohen në bazë të rëndësisë, ka dallim të madh në mes të falsifikimit të vërtetimit tatimor dhe mashtrimin në mall shikuar nga pikëpamja e kostos në para. Për tenderin e komunës së Kaçanikut shihet se vlera e mashtrimit potencial është shumë më e madhe se siguria e ekzekutimit e cila është konfiskuar. Në këtë rast AK e ka vërejtur mashtrimin që mund t'i bëhej, por siç D+ ka gjetur në raportet e kaluara, mund edhe të mos vërehet<sup>70</sup>.

67 Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2012. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2815>

68 OSHP. Vendimi 163/19. 2019 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/163-19vendim-lz.pdf>

69 Intel Core i3 7020U dhe Intel Celeron N3350 <https://ark.intel.com/content/www/us/en/ark/compare.html?productids=95598,122590>

70 Demokraci Plus. Drejt Komunave me Prokurim Publik të Hapur, Llogaridhënës dhe Efikas. faqe 62. 2018 <http://www.dplus-ks.org/wp-content/uploads/2018/12/2018-12-03-Drejt-komunave-me-prokurim-t%C3%AB-hapur-llogaridh%C3%ABn%C3%ABs-dhe-efikas-ALB-Final.pdf>

# VENDIMET PËR (MOS) GJOBITJE TË AK

OSHP mund të vendosë gjoba ndaj AK kur ato nuk i respektojnë vendimet e panelit, urdhëresat apo edhe kur ka shkelje të vazhdueshme nga AK. Gjoba sipas nenit 131 të LPP-së nuk duhet të jetë më pak se 5,000 euro. Sipas D+, OSHP i ka gjobitur disa AK që nuk do të duhej të gjobiteshin ndërsa të tjera që do të duhej të gjobiteshin, nuk janë gjobitur. Në vazhdim paraqiten dy raste ku OSHP do të duhej të vendoste ndryshe prej vendimet që kishte marrë.

## Gjoba kundër Trepçës

Trepça kishte shpallur tenderin “Furnizim me pjesë rezervë për ngarkuesit Wagner ST2D” në fillim të vitit 2018. Deri në zgjedhjen e fituesit në OSHP kishte katër ankesa. Si rezultat, nënshkrimi i kontratës u bë vetëm në fund të vitit 2018. OSHP tre herë ktheu tenderin në rivlerësim, ndërsa vërtetoi dhënin e kontratës në herën e katërt. Në tender kishin ofertuar katër kompani, ndërsa pas çdo rivlerësimi Trepça zgjodhi një fitues të ndryshëm, përderisa kontratën në fund e fitoi kompania Profitech.

Si rezultat i ankesave në OSHP, Trepça kishte mbetur pa pjesë rezervë për një makineri shumë të rëndësishme. Pas ankesës së katërt, të bërë nga kompania Segment Kosova, Trepça shpalli tender tjetër me titull të njëjtë. Procedura e përdorur ishte procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Fitues i tenderit u zgjodh kompania SNR, ndërsa vlera e kontratës ishte 17,684.14 euro. Kundër këtij vendimi në OSHP u ankua Profitech, por pasi ishte procedurë e negociuar, Trepça nuk e pezulloi tenderin por nënshkroi kontratën pa prituri afatin ligjor për ankesa, gjë që lejohet me nenin 26.4.1 të LPP-së. Kontrata u nënshkrua më 13 nëntor 2018, ndërsa zbatimi i saj do të bëhej brenda 30 ditëve. Për arsye të

mospezullimit të tenderit, paneli vendosi gjobë në vlerë prej 5,000 euro ndaj Trepçës, por edhe vërtetoi dhënin e kontratës duke marrë parasysh interesin publik dhe gjithashtu pasi kontrata ishte implementuar në tërësi<sup>71</sup>. Arsyetim tjetër i panelit ishte se AK ka lidhur kontratën dhe ka realizuar furnizimin edhe pse ka pasur ankesë në OSHP. Ky arsyetim lë të kuptohet se AK nuk ka të drejtë të shpallë tender tjetër nëse për të njëjtin furnizim ka ankesë në OSHP. Ky arsyetim mund të përdoret ndoshta për tenderët për punë dhe shërbime të cilat realizohen vetëm njëherë, pra nuk mund të përsëriten, shembull nuk mund të shtrohet e njëjta rrugë dy herë, pra nuk mundet të jenë dy tenderë. Për furnizime, siç është rasti me këtë tender, mundet të shpallen edhe dy apo më tepër tenderë, pra edhe nëse ka ankesë në OSHP. Arsyeja është se furnizimet ndodhin vazhdimisht, pra mund të ketë dy tenderë për furnizim me pjesë rezervë, ose për furnizim me material higjienik. Furnizimet mund të ruhen në magazinat e AK deri sa të shfaqet nevoja për t'i përdorur. LPP dhe Udhëzuesi me asnjë dispozitë nuk e ndalon shpalljen e një tenderi tjetër nëse i pari është duke u shqyrtuar në OSHP.

Ekspertët për këtë tender, ai shqyrtues Ilir Halili dhe ai teknik Zivçe Sarkoçeviq dhanë rekomandim që tenderi të kthehet në rivlerësim. Por ky rekomandim nuk ishte logjik pasi kontrata ishte nënshkruar me 13 nëntor 2018, ndërsa ekspertët rekomandimin e tyre e dhanë më 12 dhjetor 2018, pra 30 ditë pas datës së nënshkrimit të kontratës, i cila ishte edhe afati kur do të përfundonte kontrata. Pra nuk mund të kthehej në rivlerësim tenderi për të cilin kontrata veçse kishte përfunduar.

Arsyetimi i panelit se gjoba është vendosur për arsye të mospezullimit të tenderit do të mund të ishte bindës po të vepronte njëjtë me një rast tjetër më herët. Komuna e Prishtinës për tenderin për sigurim fizik kishte përdorur të njëjtin procedurë, pa publikim të njoftimit për kontratë. Komuna,

71 OSHP. Vendimi 680/18. 2019

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/680-18vend.pdf>

njëjtë si Trepça nuk kishte pezulluar tenderin, por kishte nënshkruar kontratën me kompaninë K.S.AS Security. Në këtë rast paneli vërtetoi dhënin e kontratës, por nuk vendosi gjobë kundër komunës<sup>72</sup>.

Paneli përdori pikërisht nenin 26.4.1 të LPP-së për të arsyetuar veprimin e komunës, gjë të cilën nuk e bëri në vendimin për Trepçën. Ky nen thotë:



**4.1. SË PAKU DHJETË (10) DITË KANË KALUAR NGA DATA E PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT PËR DHËNIEN E KONTRATËS; ME KUSHT QË, KY KUSHT TË MOS APLIKOHET PËR PROKURIMET URGJENTE QË SIPAS NENIT 35.2.1 (III). APO PËR NJË AKTIVITET TË PROKURIMIT TË BAZUAR NË NENIN 36. APO PËR KONTRATA ME VLERË MINIMALE.**

ishite shpallë e papërgjegjshme në dy vlerësimet e kaluara. MI duke keqinterpretuar afatin për ankesa dhe duke mos e pezulluar aktivitetin nënshkroi kontratën me Alko Impex. Deri në vendimin e tretë të OSHP, kishin përfunduar rreth 40% të punëve. Paneli pati parasysh interesin publik në këtë rast dhe vendosi që të vërtetohet vendimi për dhënie të kontratës<sup>75</sup>.

Si pasojë e shkeljeve të bëra nga AK për këtë tender, ndër to keq llogaritje e afatit kohor për kërkesën për rishqyrtim dhe mospezullim të tenderit, paneli do të duhej ta gjobiste MI për shkelje të LPP-së. Si bazë për gjobë, paneli mund të bazohej edhe në një vendim tjetër të mëhershëm ku menaxherit të prokurimit të MI i është dhënë vërejtja e fundit<sup>76</sup>.

## Mos gjoba ndaj Ministrisë së Infrastrukturës

Për tenderin “Sanimi i tunelit në rrugë nacionale N2 segmenti Mitrovicë- Çabër” të Ministrisë së Infrastrukturës (MI) konzorciimi K-Ing & Eskavatori ishte ankuar tre herë në OSHP. Për këtë tender krahasuar me atë të Trepçës ishte përdorur procedura e zakonshme, ajo e hapur. Në vendimin e parë<sup>73</sup> dhe të dytë<sup>74</sup> paneli ktheu tenderin në rivlerësim duke aprovuar pretendimet e K-Ing & Eskavatori ndaj OE të rekomanduar për kontratë, Shkoza F07 & Dijamanti.

Pas rivlerësimit, MI zgjodhi fitues kompaninë Alko Impex, e cila nuk ishte ankuar asnjëherë. Për më tepër kjo kompani

72 OSHP. Vendimi 220/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/220-18vend.pdf>

73 OSHP. Vendimi 208/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/208-18vendim.pdf>

74 OSHP. Vendimi 380/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/380-18vendim.pdf>

75 OSHP. Vendimi 571/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/571-18vend.pdf>

76 OSHP. Vendimi 131-132-138-140-143-148/18. 2018

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/131-132-138-140-143-148-18-vend.pdf>

# REKOMANDIMET E EKSPERTËVE

Ekspertët e OSHP përzgjedhen nga paneli për të bërë një ekspertizë në lidhje me ankesat e OE. Janë dy kategori të ekspertëve; ekspertët shqyrtues që merren me shqyrtimin e pretendimeve që lidhen me procedurat e prokurimit, LPP dhe Udhëzuesin, si dhe ekspertët teknik që kanë njohuri më të thella për një fushë të caktuar. Përzgjedhja e tyre bëhet në bazë të shkollimit dhe njohurive që ata kanë për një fushë të caktuar. Rekomandimet e ekspertëve janë shumë me rëndësi pasi paneli në mungesë të njohurive profesionale për shumë fusha të caktuara vendos duke u bazuar në rekomandimet e tyre.

Në shumë raste ku vendimi i panelit përputhet me rekomandimin e ekspertit, arsytimi i vendimit është i njëjtë fjalë për fjalë me rekomandimin e ekspertit. Ky veprim e shton ndikimin e ekspertit te paneli, dhe pasi ekspertët janë të ndryshëm kjo bën që të rritet jokonsistenca në mes të vendimeve për çështje të njëjta, por që nuk e kanë ekspertin e njëjtë. Në vazhdim janë të paraqitura vendimet ku ekspertët, sipas D+ kanë dhënë rekomandime të gabuara.

## SNR v. Trepça, 278/18

OE SNR ishte ankuar në OSHP kundër vendimit të AK Trepça për dhënie të kontratës me pretendimin ankimor se SNR ishte eliminuar pasi kishte dorëzuar certifikatën ISO 18001 me afat të skaduar. Eksperti Basri Fazliu tha se një OE nuk mund të eliminohet për një kërkesë që nuk është në dosje të tenderit. Kërkesa për certifikatë ISO 18001 ishte shtuar në njoftimin për korrigjim të gabimeve, të cilën eksperti siç duket nuk e kishte vërejtur. Rekomandimi i tij ishte që tenderi të kthehet në rivlerësim. Duke përsëritur arsyetimet e ekspertit, paneli mori vendim që tenderi të kthehet në rivlerësim, ndërsa ankesa të aprovohet<sup>77</sup>. Eksperti shqyrtues po

ta vërente që edhe ISO 18001 kërkohej në dosje të tenderit, atëherë rekomandimi i tij do të duhej të ishte që të vërtetohet vendimi i AK. Me këtë rekomandim edhe paneli do të mund të merrte vendim që të vërtetohet vendimi i AK.

## Sigma v. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 396/18

OE Sigma ishte ankuar në OSHP kundër vendimit të MFSK për dhënie të kontratës. Pretendimi ankimor i Sigma ishte se OE fitues nuk kishte ofruar në dosje të tenderit certifikatë nga risiguruesi. Në dosje të tenderit kërkohej që OE të jenë të risiguruar në kompani më të mëdha që kanë klasifikim A+ sipas klasifikimit të bërë nga kompania Standard & Poor's. OE fitues kishte një dokument ku thuhet se Butcher Robinsone & Staples International Limited do të konsideronte të ofrojë (në anglisht termi i përdorur në këtë dokument është "will consider") mbulim të risigurimit deri në 100%. Këtë e tha edhe eksperti i cili përdori fjalën mund të ofrojë mbulim fakultativ të risigurimit deri në 100%. Eksperti Hysni Muhadri konsideroi se ky dokumente e plotësonte kërkesën e AK. Mirëpo, AK kishte kërkuar risigurim e jo ndonjë dokument ku një kompani do ta konsideronte risigurimin. Përndryshe OE ankues në këtë rast e kishte ofruar dokumentin ashtu siç kërkohej me dosje të tenderit. Eksperti me këtë interpretim të gabuar rekomandoi që ankesa të refuzohet.

Paneli në arsyetimin e vendimit pati parasysh se dokumenti i OE fitues ka fjalët "mund të sigurohet", ndërsa ai i OE ankues thotë që është "i risiguruar". Në vendim gjithashtu fjala "mund" është e theksuar me ngjyrë të zezë, për të treguar që tek kjo fjalë është dallimi. Paneli vendosi që ankesa të aprovohet dhe tenderi të kthehet në rivlerësim<sup>78</sup>.

77 OSHP. Vendimi 278/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/278-18vend.pdf>

78 OSHP. Vendimi 396/18. 2018.  
[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/396-18vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/396-18vendim_1.PDF)

### Doni Term – Klimaterm & Ekoterm v. KEK, 71-75/19

OE Doni Term dhe Klimaterm & Ekoterm kishin kontestuar referencat për punë të ngjashme për kompaninë fituese H&B Consulting. Kërkesa e AK në dosje të tenderit ishte që ofertuesi të dorëzojë së paku një referencë apo pranim teknik të projekteve të ngjashme të përfunduara. Titulli i tenderit ishte “Funksionalizimi i objektit ekzistues të menzës së re të punëtoreve në TC-A, pjesa mekanike - ngrohje dhe ventilim”. Pra sipas titullit kërkoheshin referenca për projekte të ngjashme për ngrohje dhe ventilim. Ankuesit pretenduan që referencat e H&B Consulting ishin për ndërtim dhe renovim të objekteve e jo për ngrohje dhe ventilim. Eksperti shqyrtues, Muhamet Kurtishaj rekomandoi që ankesat të refuzohen. Arsyetimi i tij ishte se katër referencat e H&B Consulting kanë kodin 45331000-6 të Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP)<sup>79</sup>, të cilin kod e kishte edhe tenderi në ankesë. Por katër referencat e H&B Consulting nuk e kanë pasur këtë kod. Në dosjet e tenderët të publikuar në uebfaqen e KRPP për këto referenca kodi i FPP është 45000000-7<sup>80</sup>18283 që është kodi për punë ndërtimi, ndërsa kodi 45331000-6 është për punë instalimi të ngrohjes, ventilimit dhe ajrit kondicional. Paneli vërtetoi vendimin për dhënie të kontratës, ndërsa arsyetimi ishte fjalë për fjalë i njëjtë me atë të ekspertit. Paneli nuk ka bërë fare verifikim të referencave edhe pse gjatë seancës ankuesit pretendonin që OE fitues nuk ka referenca në punë të ngjashme. Në këtë rast paneli është vënë në lajthitje nga eksperti shqyrtues në lidhje me kodin FPP.

### International Security Association v. KK Obiliq, 106/19

Për tenderin “Sigurimi fizik i objektit komunal” International Security Association ishte ankuar në OSHP me pretendimin se OE i rekomanduar Rosa Security me çmimin e ofruar nuk mbulon shpenzimet e pagave për punëtorët. Ekspertja Shefkinaze Vllasaliu, duke u mbështetur në formën online<sup>84</sup> për të llogaritur pagën bruto/neto në uebfaqen e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) erdhi në përfundim se oferta e Rosa Security është më e lartë se shpenzimet për paga. Rekomandimi i saj ishte që ankesa të refuzohet.

Mirëpo ajo që nuk e ka llogaritur ekspertja është kontributi i punëdhënësit, që është 5% e pagës bruto. Kalkulatori e llogarit këtë por nuk e përfshin në total, pasi kalkulatori ju shërben personave fizik për të parë elementet e pagës bruto (paga neto + tatimi në të ardhura + kontributi pensional i punëtorit). Pagës bruto të punëtorit kur i shtohet edhe kontributi pensional i punëdhënësit, atëherë oferta e Rosa Security del më e ulët se shpenzimet, që nënkuptohet se me këtë ofertë Rosa Security nuk do të mund t'i paguante punëtorët sipas Ligjit të Punës.

Duke u mbështetur në fjalët e OE ankues, paneli e ktheu tenderin në rivlerësim, duke kërkuar nga AK që të vërtetojë përmes ATK se a duhet t'i shtohet 10% kontribut pensional pagës neto (5% nga punëdhënësi dhe 5% nga punëtorit)<sup>85</sup>.

## Rekomandimet jokonsistente të ekspertëve

Përveç vendimeve jokonsistente të panelit, ka edhe rekomandime kundërtënëse të ekspertëve për çështje të caktuara. Pasi paneli merr më shumë se 500 vendime në vit mesatarisht, ndërsa ekspertët kanë rreth 50 raste në vit, është më e lehtë për ekspertët që të jenë konsistent në rekomandimet e tyre. Por sipas rasteve të paraqitura më poshtë, jo gjithmonë ekspertët rekomandojnë njëjtë për pretendim e njëjtë ankimor.

### Muhamet Kurtishaj

Eksperti shqyrtues Muhamet Kurtishaj në dy vendime për pretendimin për çmim jonormalisht të ulët ka dhënë rekomandime kundërtënëse. Në ankesën 43/18 të kompanisë Graniti Com kundër vendimit të komunës së Skënderajit për dhënie të kontratës, një nga pretendimet ishte se oferta e OE të rekomanduar ishte me çmime jonormalisht të ulëta. Eksperti llogariti tenderin jonormalisht të ulët sipas formulës nga formulari B57 dhe konstatoi që nuk janë plotë-

79 FPP i definon aktivitetet e prokurimit me shifra. Për shembull renovimi e ka një shifër të veçantë, furnizimi me dru një tjetër shifër, e kështu me radhë.

80 <https://bit.ly/2W4ancd>

81 <https://bit.ly/2JW6ui9>

82 <https://bit.ly/2I1CW03>

83 <https://bit.ly/2wh3MMA>

84 Kalkulatori i pagave. Administrata Tatimore e Kosovës.

<http://www.atk-ks.org/kalkulatori-i-pagave-nga-neto-ne-bruto/>

85 OSHP. Vendimi 106/19. 2019

<http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/106-19vend.pdf>

suar kushtet që oferta e OE të rekomanduar të cilësohet si e tillë. Graniti Com gjatë seancës ceku që OE i rekomanduar në 30 pozicione kishte dhënë çmimin prej një cent. Paneli edhe pse tenderin e ktheu në rivlerësim, për këtë pikë të ankesës u arsyetua se nuk janë plotësuar kriteret që oferta e OE të rekomanduar të trajtohet si ofertë me çmim jonormalisht të ulët<sup>86</sup>.

Në një rast tjetër, ku ankues ishte kompania Europa për tender për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve, eksperti dha rekomandim ndryshe. Europa kishte vetëm një pretendim ankimor: OE i rekomanduar D-Rrahmani kishte ofruar me çmime jonormalisht të ulëta, konkretisht D-Rrahmani 72 pozicione në paramasës i kishte me çmim 10 cent. Gjithashtu sipas formulës, oferta e tij mund të cilësohej si jonormalisht e ulët. Eksperti rekomandoi që ankesa të refuzohet pasi sipas tij është e drejtë e AK vlerësimi i çmimit.



Eksperti ceku nenin 61.1 të LPP-së i cili thotë:

*Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni<sup>87</sup>.*

Pasi AK nuk e kishte cilësuar ofertën e OE të rekomanduar si jonormalisht të ulët, nuk mund të përdorej as formula, arsyetoi eksperti.

Këto dy rekomandime të Muhamet Kurtishajt vërehet se janë kundërthënëse. Në asnjërin nga tenderët AK nuk i kishte cilësuar ofertat si jonormalisht të ulëta. Eksperti në ankesën e Graniti Com kishte llogaritur tenderët sipas formulës, ndërsa

në ankesën e Europa këtë nuk e ka bërë. Duke u mbështetur nga të dhënat në Databazën e Vendimeve të OSHP-së, Muhamet Kurtishaj nga viti 2017 ka qenë i caktuar si ekspert vetëm në tetë ankesa, ku një nga pretendimet ankimore ka qenë për çmim jonormalisht të ulët. Prandaj eksperti e ka pasë shumë të lehtë që të shikojë se si ka rekomanduar në të kaluarën për këtë çështje. Ai duhet që për pretendimet për çmim jonormalisht të ulët ose të shqyrtojë pretendimin e të bëj llogaritjet sipas formuleve ose të deklarojë se përcaktimi se a është një ofertë jonormalisht e ulët është e drejtë e AK.

Paneli e ktheu tenderin në rivlerësim<sup>88</sup> dhe obligoi AK që të analizojë çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë.

### Xhevdet Bushi

Në dy vendime për tejkalim të buxhetit për lot, eksperti shqyrtues Xhevdet Bushi dha rekomandim kundërthënëse. Komuna e Prizrenit në tenderin për mirëmbajtje verore dhe dimërore kishte eliminuar OE Is Company me arsyen se kishte tejkaluar vlerën e parashikuar për lot. Mirëpo në dosje të tenderit AK nuk e kishte ndarë këtë vlerë për lot, por ishte dhënë vetëm buxheti total. Xhevdet Bushi me të drejtë rekomandoi që të aprovohet ankesa me arsyen se nuk mund të cilësohej tejkalim i buxhetit pasi nuk dihej sa është vlera e parashikuar për secilin lot. Të njëjtin mendim e pati edhe paneli, duke e kthyer tenderin në rivlerësim<sup>89</sup>.

Në një rekomandim tjetër të vitit 2018, eksperti rekomandoi për rivlerësim të tenderit edhe pse oferta e Liri Med për lot 6 dhe 14 kishte tejkaluar buxhetin vlerën e parashikuar për 11.5% dhe për 267% respektivisht. AK në dosje të tenderit kishte përcaktuar vlerën e parashikuar për secilin lot, megjithatë paneli vendosi për rivlerësim të tenderit.

Nga këto dy rekomandime mund të kuptohet se eksperti rekomandon për rivlerësim për tejkalim të buxhetit, pavarësisht a është dhënë buxheti për lot në dosje të tenderit apo jo.

86 OSHP. Vendimi 43/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/36-43-44-18vendim.pdf>  
 87 Neni 61. Ligji për Prokurim Publik. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2011.  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>  
 88 OSHP. Vendimi 63/19. 2019  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/63-19vend.pdf>  
 89 OSHP. Vendimi 108/19. 2019  
<http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/108-19%20vend.pdf>

# REKOMANDIME

Duke u bazuar në gjetjet e prezantuara këtij raporti, dhe monitorimin e vazhdueshëm të OSHP-së, D+ propozon këto masa për të përmirësuar mekanizmin e procedimit të ankesave në prokurim publik:

- OSHP të marrë një qëndrim në lidhje me shqyrtimin e pretendimeve të cilat kanë të bëjnë me shkeljet e ligjeve të veçanta apo legjislacionit dytësor. Kërkesat në dosje të tenderin prekin shumë fusha që rregullohen përmes ligjeve tjera. OSHP duhet që të vendosë që t'i marrë parasysh të gjitha ligjet tjera gjatë marrjes së vendimit ose mos t'i marrë parasysh fare. Përdërisa OSHP aplikon shumë ligje tjera gjatë marrjes së vendimit (edhe kur nuk kërkohen në dosje të tenderit që ato të respektohen), atëherë do të duhej që t'i marrë parasysh të gjitha ligjet.
- OSHP të evitojë rivlerësimin e panevojshëm të tenderëve aty ku është e mundur. Në raportin paraqiten raste kur OSHP ka mundur të marrë vendimin e duhur që në ankesën e parë, por ka një tendencë për të kthyer tenderët në rivlerësim. Evitimi i rivlerësimeve të panevojshme mund të bëhet duke rritur kapacitetin e anëtarëve të panelit dhe ekspertëve për fusha në të cilat nuk kanë njohuri të mjaftueshme teknike. Poashtu, OSHP duhet të sigurohet që të angazhojë ekspertë të kualifikuar të fushave përkatëse në mënyrë që të evitohet rivlerësimi i panevojshëm tenderëve sidomos për shkak të gabimeve bazike në llogaritje matematikore.
- OSHP të mos aprovojë ankesat vetëm që të mos konfiskohet tarifa e ankesës. OSHP do të duhej që të konfiskojë më shpesh tarifën, ndër to ankuesve që një herë janë shpallë të papërgjegjshëm nga OSHP por ankohen përsëri për të njëjtin tender.
- OSHP të krijojë një databazë të avancuar të vendimeve të saj në mënyrë që të sigurojë konsistencë në vendimmarrje. OSHP do të duhej që për një çështje të caktuar të vendosë gjithmonë njëjtë. Edhe pse tenderët kanë karakteristika të ndryshme, rastet si tejkalim i vlerës së parashikuar apo vërtetimi që OE nuk ka borxhe ndaj ATK-së, do të duhej gjithmonë të vendosen njëjtë. Kjo do të shtonte rëndësinë e precedentit në shqyrtimin e ankesave;
- OSHP të bëjë monitorimin dhe kontrollin e ekspertëve për të siguruar cilësi dhe paanshmëri, e sidomos kur ndaj tyre ka pretendime se nuk e kanë kryer punën si duhet. Pasi D+ ka gjetur në dy raste shkelje të mëdha në rekomandimin e ekspertëve, do të duhej që të ketë një auditim të rekomandimeve të tyre. Këtë OSHP do të duhej ta bënte duke kontraktuar ndonjë palë të tretë.
- Të bëhet matje e cilësisë së performancës së secilit ekspert duke përcjellur suksesin e rekomandimeve të tij/saj, afatin e trajtimit të lëndëve dhe indikatorë të tjerë, për të përcaktuar nëse duhet të mbahet në atë pozitë apo të zëvendësohet;
- OSHP të marrë qëndrim rreth interpretimeve të KRPP-së, pasi në disa raste i konsideron ato si obligative e në disa raste jo. Kjo do ta eliminonte rrezikun për akuza ndaj OSHP-së se merr parasysh interpretimet e KRPP-së në mënyrë selektive.
- OSHP të ndryshojë interpretimin për diskualifikim të operatorëve ekonomik pasi interpretimi aktual është shumë i ngushtë dhe i lejon operatorët ekonomik që kanë deklaruar rrejshëm apo kanë tentuar të mashtrorjnë të mbesin të pa ndëshkuar. OSHP në këtë rast të ketë parasysh nenet e dosjeve të tenderit, të cilat OE i pranojnë në momentin që dorëzojnë ofertën.



- Operatorët e përfshirë në listën e zezë të suspendohen nga platforma e e-Prokurimit;
- OSHP t'i kushtojë vëmendje më të madhe zbatimit të vendimeve të saj, duke krijuar mekanizma monitorues të zbatimit të vendimeve dhe të aplikojë masa ndëshkuese për AK të cilat nuk i zbatojnë vendimet apo të cilat shkelin afatet;
- OSHP të vendosë gjopa për AK që bëjnë shkelje të përsëritura të vendimeve të OSHP-së;
- Të mbahen seancat e hapura për të gjitha ankesat. Kjo do ta largonte perceptimin e mundshëm nga publiku se OSHP ka diçka për të fshehur në seancat e mbyllura.
- Të bëhet publikimi i të gjitha vendimeve, ankesave, raporteve të ekspertëve si dhe dokumenteve tjera që janë me rëndësi në një format të lexueshëm elektronikisht;

